



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Inxhinieri Pyjore”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Taulant Bino

2. Genti Kromidha

Shator/2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; 200 – 400 fjalë

Programi i studimit është unik dhe nuk ofrohet nga ndonjë IAL tjetër në vend. Kurrikula e programit është bazuar në eksperiencat më të mira ndërkombëtare të kohës, por nuk është ndryshuar që nga viti 2009. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studenteve dhe garanton një shpërndarje pothuajse uniforme të ngarkesës në semestra të ndryshëm gjatë ciklit të studimit.

Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi mbështetës dhe mundësive të barabarta të personelit për kryerjen e detyrave. Mjediset e punës, laboratorët, sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka janë lirisht të aksesueshme nga personeli dhe studentët për kryerjen me profesionalizëm të detyrave të tyre. Institucioni interesohet për kualifikim e vazhdueshëm të personelit.

Në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, UBT ka ndërtuar një sistem për menaxhimin e informacionit online bazuar mbi platformën ESSE3. Ky sistem menaxhon gjithë informacionin dhe dokumentet e stafit akademik, ndihmës e administrativ. Sistemi lejon aksesimin dhe komunikimin nëpërmjet adresave të postës elektronike

Nga takimet e realizuara në institucion me drejtuesit dhe stafin akademik pranohet mungesa e fondeve të nevojshme për kryerjen e plotë të praktikave profesionale në terren. Gjithashtu mungesa e fondeve kufizon edhe zhvillimin e kërkimit shkencor në nivelin e duhur.

Numri i studentëve që ndjekin këtë program studimi është relativisht i ulët dhe cilësia e tyre në hyrje mjaft e dobët. Programi i studimit vlerësohet si i vështirë nga studentët dhe me mundësi të kufizuara punësimi, kjo theksuar edhe nga situata kaotike dhe ndryshimet e vazhdueshme në sektorin pyjor në vend.


Gjatë takimit me studentët ata u shprehën se nuk kanë dijeni dhe kanë pak interes për përfaqësimin e tyre në strukturat e ndryshme të FSHP dhe UBT në përgjithësi. Edhe pse në UBT funksionojnë Këshillat studentore dhe Forumi studentor, nevojitet punë më e kujdesshme për përfshirjen dhe përfaqësimin e të gjithë studentëve.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; (rreth 200 fjalë)

Grupi i vlerësimit të jashtëm është përzgjedhur nga lista e eksperteve të jashtëm të vlerësimit, miratuar nga Bordi i Akreditimit. Ekspertet e përzgjedhur morën pjesë në trajnimin e organizuar nga ASCAL më 03.05.2019, mbi kryerjen e vlerësimit të jashtëm të programeve të studimit bazuar në standardet e reja të sigurimit të cilësisë. Nëpërmjet sistemit elektronik AMS të ofruar nga ASCAL, ekspertet u njohën me raportin e vlerësimit të brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga institucioni i arsimit të lartë që po vlerësohet. Në datat 10-11 Qershor 2019, grupi vlerësimit të jashtëm vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh, intervistash e vëzhgimesh me stafin akademik dhe ndihmës në mjediset e institucionit. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës në terren.

Më datë 31.07.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 44/56 Prot., datë 01.08.2019, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 16.09.2019, me shkresë zyrtare me Nr. 307 Prot., datë 10.09.2019, Institucioni përcjell përgjigjen mbi Draft-Raportin, përmes së cilës shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij. Sa më lart, Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Inxhinieri Pyjore”

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE**

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i ciklit të dytë “Inxhinieri Pyjore” ose ndryshe Master Shkencor në Inxhinieri Pyjore, është hapur në vitin 2008 me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1244, datë 10.09.2008 “Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009” (Aneks 7).</p> <p>Ky program mbulon një burim natyror dhe fushë veprimi kombëtare tejet të rëndësishme, menaxhimi i së cilës është jetij në përmbushjen e shume prej nevojave të vendit dhe të popullsisë. Sa më sipër provon se programi nuk bie ndesh me interesat kombëtare të vendit</p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>UBT përfaqëson një prej institucioneve akademike me përvojë unike në vend në fushën e menaxhimit të pyeve dhe kullotave, me një staf pedagogjik dhe kërkimor po kështu me shumë përvojë që kontribuon në programin e këtij cikli studimi.</p> <p>Programi i studimit i ofruar në Masterin Shkencor Inxhinieri Pyjore është i bazuar dhe ruan më së miri këtrë përvojë shumë-vjecare.</p> <p>Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur ne DVV (Aneks 7, 8 dhe 9) si dhe në vizitën pranë institucionit, GVJ konfirmon se ky program studimi synon ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare.</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Sipas planit mësimor të programit të studimit Master i Shkencave Inxhinieri Pyjore (Aneksi 12) rezulton se “programi synon përgatitjen e specialistëve të aftë nga pikëpamja profesionale e shkencore të mbarështrojnë në mënyrë të integruar burimet pyjore, duke siguruar kështu një zhvillim të qëndrueshëm të tyre nga pikëpamja ekologjike, ekonomike e sociale.”.</p> <p>Programi përputhet kryekëput më qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së UBT dhe Fakultetit të Shkencave Pyjore. Ky fakultet dhe vetë UBT kanë formuar ndër vite, specialistë të fushës së pyjeve, mjedisit, bujqësisë dhe burimeve të tjera natyrore apo biologjike.</p> <p>Gjatë takimeve me stafin në institucion është konfirmuar ndërlidhja dhe bashkëveprimi horizontal ndërmjet njësive të ndryshme në institucionin e UBT si në fushën e mësimdhënies (shkëmbimi i stafit pedagogjik ndërmjet njësive të ndryshme) dhe në atë të kërkimit shkencor.</p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Pyjet dhe kullotat përbëjnë burime natyrore të qënësishme për ekonominë vendore. Kjo është edhe më e theksuar në vendin tonë ku ende një pjesë e mirë e popullsisë jeton në zonat rurale.</p> <p>Menaxhimi i mirë i këtyre burimeve natyrore është i domosdoshëm dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë lokale.</p> <p>Ky program mbulon kështu një burim natyror tejet të rëndësishëm dhe dijet e shpërndara në program nxisin zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar.</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Programi Master Shkencor në Inxhinieri Pyjore krijon baza të mira të njohurive shkencore dhe profesionale për të vijuar në studime të thelluara të ciklit të tretë. Kjo konfirmohet nga struktura e programit paraqitur në Kurrikulën e programit të Studimit (Aneks 13).</p> <p>Megjithatë ndërprerja e ciklit të tretë të studimeve pranë UBT-së paraqet një pengesë në vazhdimësinë e studimeve të thelluara shkencore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi I.2 Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Plani Strategjik i Universitetit Bujqësor të Tiranës 2016-2025 shprehet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • UBT kërkon të përgatisë jo vetëm specialistë të kualifikuar të fushës së bujqësisë, të ushqimit dhe mjedisit, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë, veçanërisht për prodhimin bimor, prodhimin shtazor; hortikulturë; mbrojtjen bimësh; akuakulturën dhe peshkimin; agromjedisin & mbrojtjen e tij; ekonominë agrare; politikat bujqësore; zhvillimin e integruar rural; menaxhimin e ndërmarrjeve; marketingun; financën & kontabilitetin; agroturizmin, bioteknologjinë dhe ushqimin; industrinë e pijeve; mbarëshkrimin e pyjeve; industrinë e drurit; mjeksi veterinarë & shëndet publik. • UBT ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushat: prodhim bimor, prodhim shtazor; hortikulturë; mbrojtje bimësh; akuakulturë dhe peshkimi; agromjedis & mbrojtjen e tij; ekonomi agrare; politikat bujqësore; zhvillimi i interguar rural; mmenaxhimi i

	<p>ndërmarrjeve; marketing; financë & kontabiliteti; agroturizëm, bioteknologji dhe ushqim; industrinë e pijeve; mbarështimin e pyjeve; industrinë e drurit; mjeksinë veterinarë & shëndetin publik etj.</p> <p>Plani Strategjik shpjegon aktivitetin kërkim-shkencë në FSHP si dhe shpjegon fushat e veprimit të këtij fakulteti.</p> <p>Mbështetur në sa më sipër, programi i studimit ofrohet në përputhje me të UBT-se, për t'u shndërruar në një universitet lider në arsimin kombëtar në fushën e bujqësisë dhe pyjeve.</p> <p>Programi synon përgatitjen e specialistëve të aftë nga pikëpamja profesionale e shkencore për mbarështrimin e integruar të burimeve pyjore, duke siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.</p> <p>RVB citon dhe Statutin e UBT (Aneks 67) dhe Planin Strategjik të UBT për 2016-25 (Aneks 47). Por këto anekse nuk ndodhen në dokumentet plotësuese të RVB-së.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritarë akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti dhe rregullorja UBT përcaktojnë drejtimit akademike të institucionit dhe shprehen edhe mbi programin e ciklit të dytë ose Masterin Shkencor Inxhinieri Pyjore.</p> <p>Kjo citohet në pikën 1 të Nenit 2, pika 1 Neni 59, të Statutit të UBT si dhe në faqe 69 të Rregullores së UBT (2017).</p> <p>Sikurse theksuar dhe më lartë Statuti i UBT (Aneks 67) dhe Plani Strategjik i UBT për 2016-25 (Aneks 47) nuk ndodhen në dokumentet plotësuese të RVB-së.</p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi i programit është në përputhshmëri të plotë me fushat akademike të mbuluara nga institucioni. Këto drejtime akademike janë të sanksionuara në Statutin e UBT (Neni 2 dhe 59) si dhe në Rregulloren e UBT (faqe 69)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Sikurse thënë më parë programi është në përputhje me interesat kombëtare. Ndër të tjera, këto interesa janë të shprehura edhe në Strategjitë kombëtare sikurse Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020.</p> <p>Në kuadër të vizionit “Për një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, përmes menaxhimit të integruar” SKZHI përakton si objektiv strategjik “Forcimin e menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve të pyjeve dhe kullotave” nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 4.1 uljes së prerjeve të paligjshme të pyjeve deri në vitin 2020; • 4.2 hartimit të planeve të mbarështimit për të gjitha ekonomitë pyjore në vend; • 4.3 rehabilitimit i zonave të degraduara;

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>GVJ u njoh me objektivat e programit Master i Shkencave Inxhinieri Pyjore nëpërmjet shqyrtimit të RVB, takimit me Departamentin e Pyjeve (pranë FSHP) si dhe me dokumentat e vendosur në anekse përfshirë Planin Mësimor “Master Shkencor Inxhinieri Pyjore” viti 2015-2016, 2018-2019 (Aneks 12 dhe Aneks 15), Kurrikula e programit të Studimit (Aneks 13 dhe 14)</p> <p>Plani përcakton qartësisht objektivat ndërsa kurrikula sqaron njohuritë dhe kompetencat shkencore të përftuara prej studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>UBT ka krijuar, në vitin 2017, Degën e Informimit, të Orientimit dhe të Karrierës së Studentëve e cila është funksionale dhe ka në varësi Qendrën e Karrierës dhe Alumnit (QKA). Kjo qendër ka specialistë të dedikuar për të ndjekur ecurinë e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Sipas RVB, institucioni kryen një sërë veprimtarish me qëllim lidhjen e studentëve me tregun e punës dhe pasqyrimin në program të kërkesave të këtij tregu me qëllim rritjen e mundësive të punësimit (Aneks 17.1: Studim i tregut të punës).</p> <p>Institucioni organizon çdo vit Panairin e punës – në nivel universiteti, me pjesëmarrjen e kompanive dhe firmave të ndryshme. Studentët plotësojnë formularë interesi dhe kompanitë private pjesëmarrëse prezantojnë mundësitë e tyre të punësimit. Sipas referimit të stafit drejtues dhe QKA, tregu i punës për studentët e Masterit Shkencor “Inxhinieri Pyjore” në fushën e pyjeve përbëhet kryesisht nga institucione qendrore dhe vendore (njësitë përgjegjëse për menaxhimin mjedisor) dhe kompani të ndryshme.</p> <p>QKA, gjatë intervistës së kryer, tregoi se ka gjurmuar studentët e diplomuar, por niveli i përgjigjeve të kthyer mbetet i ulët, që bën të vështirë një vlerësim të plotë dhe të saktë të segmenteve të tregut të punës që cilat përthithin studentët e diplomuar në Programin Bachelor Inxhinieri Agromjedisi.</p> <p>Megjithatë, RVB nuk tregon nëse ka ndonjë studim të tregut të punës. Po kështu edhe gjurmueshmëria rezulton të jetë e ulët.</p>

	<p>Kryerja e studimit të tregut të punës dhe përmirësimi i nivelit të gjurmueshmërisë do të rrisë shkallën e informacionit të grumbulluar dhe do të ndihmojë në lidhjen më të plotë me tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Shqyrtimi i DVV prej GVJ konfirmojnë se objektivat e programit mësimor Master Shkencor Inxhinieri Pyjore synojnë formimin e specialistëve të ardhshëm të menaxhimit të pyjeve me dije dhe aftësi profesionale që i përgjigjen nevojave të tregut dhe tendencave kombëtare apo ndërkombëtare. Ato shprehen jo vetëm në dokumentat kryesore të programit (Rregullore e programit të studimeve) por edhe në Planin mësimor të programit.</p> <p>Programi nuk është ndryshuar që prej krijimit në 2008 duke argumentuar se është i përafuar me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe vlerësuar gjatë vizitës në institucion lidhur me sa më sipër shprehet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks 63: Rregullore e programit të studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore • Aneks 31: Kurrikula e programit të studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore në 2018-2019 • Aneks 17. Syllabuset shqip sipas modelit VKM 41, 21.04.2018
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Program i studimit është i përafuar me Masterin Shkencor të disa institucioneve e sidomos me Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Eberswalde - Gjermani, si rezultat i të cilit është bërë përafrimi i kurrikulës.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Pyjore/Departamenti i Pyjeve ka patur dhe vazhdon të ketë një bashkëpunim të ngushtë me Institucione homologe të vendeve të BE-së dhe të rajonit, bashkëpunim i cili ka bërë të mundur përafrimin e programeve të studimit të ofruara nga këto institucione bashkëpunuese, për të lehtësuar kështu transferimin e studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen edhe në tregun ndërkombëtar.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>GVJ konfirmon se programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Programi, mbështetet në përvojën jetëgjatë të institucionit dhe në praktikat e mira të vendeve evropiane.</p> <p>Programi është bazuar në kurrikulën e Masterit Shkencor të disa institucioneve e sidomos me Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Eberswalde - Gjermani, si rezultat i të cilit është bërë përafrimi i kurrikulës.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në</p>	<p>RVB citon se praktika realizohet nëpërmjet orëve laboratorike, studimeve të fushave të ndryshme dhe praktikës kërkimore që zhvillohet gjatë semestrit të dytë. Departamenti i Pyjeve harton programin e praktikës profesionale si dhe cakton pedagogët që do të drejtojnë zhvillimin e praktikës në objekt.</p>


direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Praktikat profesionale janë kështu pjesë e programit të studimit (shih Aneks 12). Shqyrtimi i dokumentacionit konfirmon përputhshmërinë me qëllimin dhe objektivat e programit.			
Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	Programi i studimit nuk parasheh module apo lëndë që të zhvillohen në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit. Për pasojë nuk ka dokumentacion të arkivuar që dëshmon mbi aktivitetin e zhvilluar në gjuhën angleze.			
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVB konfirmon se programi i studimit mbështetet në përvojën e mirë, kapacitetet e larta dhe burimet e duhura. Në programin e studimit janë angazhuar 13 pedagogë me kohë të plotë si pjesë e stafit akademik të FSHP-së, një pedagog staf akademik i FBM dhe një pedagog i ftuar. Stafi akademik përbëhet nga tetë Profesorë, dy Profesorë të Asociuar dhe tre pedagogë me gradën “Doktor i Shkencave”. Stafi është tërësisht i kualifikuar si rezultat i bashkëpunimeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master Shkencor Inxhinieri Pyjore” është propozuar nga Departamenti i Pyjeve. Sikurse thënë më lartë, ky departament ka gjithë kapacitetet akademike dhe kërkimore për të ofruar këtë program. Mbi të gjitha programi i studimit mbështetet kryekëput në kapacitetet akademike dhe kërkimore të Departamentit të Pyjeve.

<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Kjo përputhshmëri shikohet midis Programit Mësimor (Aneks 12) dhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetit shkencor të pesë viteve të fundit (Aneks 1) • Analizës së punës shkencore 2018 (Aneks 3) • CV-të akademike të stafit të programit të studimit (Aneks 11) 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi I.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ shqyrtoi një sërë dokumentesh të paraqitura prej Institucionit lidhur me marrëdhëniet brenda-institucionale me njësi të tjera bazë si dhe kreu vizita në institucion ku do të veçojmë takimin me stafin akademik të Programit, përgjegjësin e Departamentit të Pyjeve, Dekanin e Fakultetit të Shkencave Pyjore etj.</p> <p>RVB citon se “Një pjesë e moduleve të këtij programi ofrohen nga stafi i DEP (12 module), ndërkohë që disa module specifike ofrohen nga departamente të tjera brenda FSHP dhe UBT (3 module).</p> <p>Mbarëvajtja dhe mbikqyrja e programit të studimit bëhet në formë të koordinuar nga të gjitha instancat drejtuese të UBT-së, brenda të cilit funksionojnë një sërë zyrash përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor si: Sektori i Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional (Zyra e Studimeve dhe Studentëve, Zyra e Mësimit dhe Kurrikulave, Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional), Sektori i Informacionit dhe Transferimit të Njohurive, Sektori i IT-së dhe Mirëmbajtjes së Pajisjeve, Zyrat e Njësive Kryesore etj.”</p> <p>Bazuar në sa më sipër, GVJ konfirmon se programi mësimor realizohet kryesisht me mbulimin e personelit akademik të vetë njësisë bazë (DP) dhe personelit akademik i FSHP për lëndë më të përgjithshme. Kujtojmë se në programin e studimit janë angazhuar 13 pedagogë me kohë të plotë</p>

	<p>si pjesë e stafit akademik të FSHP-së, një pedagog staf akademik i FBM dhe një pedagog i ftuar.</p> <p>Për nevoja specifike të mësimdhënies, ndërveprohet me njësi të tjera brenda FSHP dhe UBT.</p> <p>Analiza e mësipërme mbështetet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks 1. Aktiviteti shkencor të pesë viteve të fundit • Aneks 3. Analiza e punës shkencore 2018 • Aneks 11. CV-të akademike të stafit të programit të studimit • Aneks 60. Rregullore e brendshme e FSHP • Aneks 63. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Siç është referuar në RVB dhe në takimin e Dekanin e FSHP dhe Përgjegjës të Departamentit të Pyjeve, njësia bazë ka një sërë bashkëpunimesh me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>RVB citon se “Universiteti ka nënshkruar 44 marrëveshje me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si edhe 14 marrëveshje me biznese vendase.”.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Vetë FSHP ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendase dhe të huaja sikurse treguar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks 38. Marrëveshje bashkëpunimit midis Fakultetit të Shkencave Pyjore dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit • Aneks 39. Marrëveshje bashkëpunimi FSHP- Universiteti i Shkencave të Aplikuara Eberswald Gjermani • Aneks 39.1. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet jashtë vendit • Aneks 39.2. Memorandum_FOPER_MSC • Aneks 39.3. Marrëveshja_Prizren • Aneks 39.4. Agreement_ULS_Prague • Aneks 39.5. Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të realizimit të programeve të studimit
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>FSHP ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura si dhe me Agjensinë Kombëtare të Mjedisit, për realizimin e praktikave profesionale si dhe kërkimin për të përgatitur Punimin e Diplomës në mbyllje të Masterit Shkencor.</p> <p>GVB duhet të shtojë si dokumenta plotësues marrëveshjen me AKZM dhe AKM si dhe marrëveshje të tjera me punëdhënësit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni ka një sërë bashkëpunimesh me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>RVB citon se “Universiteti ka nënshkruar 44 marrëveshje me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si edhe 14 marrëveshje me biznese vendase.”.</p>



	<p>Vetë FSHP ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendase dhe të huaja sikurse treguar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks 38. Marrëveshje bashkëpunimit midis Fakultetit të Shkencave Pyjore dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit • Aneks 39. Marrëveshje bashkëpunimi FSHP- Universiteti i Shkencave të Aplikuara Eberswalde Gjermani • Aneks 39.1. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet jashtë vendit • Aneks 39.2. Memorandum_FOPER_MSC • Aneks 39.3. Marrëveshja_Prizen • Aneks 39.4. Agreement_ULS_Prague • Aneks 39.5. Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të realizimit të programeve të studimit 			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>RVB konfirmon se analiza e përvitshme e punës mësimore dhe shkencore që përgatitet nga Departamenti i Pyjeve, trajton në detaje kontekstin e bashkëpunimit shkencor të departamentit dhe të aspekteve pozitive që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit që UBT ka me institucione të tjera në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p>Por leximi i këtyre raporteve nga GVJ del në përfundimin se Aneksi 2 (Analiza e punës mësimore) dhe Aneksi 3 (Analiza e punës shkencore) nuk shprehen mbi marrëveshjet e bashkëpunimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	

<p>Standardi I.6</p> <p>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>UBT dhe FSHP mbështetin publikimin në fushën e kërkimit shkencor nëpërmjet politikave të sanksionuara në Pikën 3.13. Prioritetet e kërkimit shkencor në UBT (Plani Strategjik i UBT 2016-25). Ndërkaq GVJ pohon se vetë UBT ka mbështetur dhe organizuar konferenca, workshope dhe aktivitete kombëtare e ndërkombëtare të shumta. Për më tepër, Revista Shqiptare e Shkencave Bujqësore e UBT-së jep gjithashtu kontribut në publikimin e punimeve shkencore.</p> <p>RVB pohon se ka një rritje në buxhetin për kërkimin por pa dhënë shifra argumentuese. Për më tepër analiza SWOT e kryer në kuadër të Vlerësimit të Punës Kërkimore Shkencore për Vitin 2018 (Aneks 3) pohon se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Grupet kërkimore-mësimore kanë karakter formal,

	<ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura laboratorike nuk i përgjigjet nvelit të kërkimit, • Puna në laboratorët e fakultetit është e fragmentarizuar dhe aspak e konsoliduar <i>dhe</i> • Mungojne fondet për kërkimin. <p>Sa më sipër u konfirmua dhe nga diskutimet e zhvilluara me Dekanatin, GVB dhe stafin e Departamentit të Pyjeve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Statuti i UBT-së sanksionon ekzistencën e strukturave të specializuara për vlerësimin e ecurisë së rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p>Këto struktura përfshijnë nga lart-poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zëvendësrektorin për Shkencën • Sektorin e Kërkimit, Kooperimit Shkencor & Projekteve. • Zyrën e Projekteve, • Zyrën e Shkencës dhe Kooperimit Shkencor, • Zyrën e Promovimit të Titujve dhe Gradave <i>si dhe</i> • Bibliotekën Universitare. <p>Vec tyre, UBT ka dhe Komisione të Përhershme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor <i>dhe</i> • Komisioni për promovimin e Personelit Akademik <p>Po kështu, në mbështetjen e kërkimit shkencor përfshihen dhe Departamentet dhe vetë Fakultetet. Departamenti i Pyjeve vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të stafit të njësisë. Pasi përfundohet kjo analizë kalon për diskutim dhe miratim final në mbledhje departamenti. Analiza vijon në nivel fakulteti dhe rektorati.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Rëndësia e kërkimit shkencor dhe politikat përkatëse për promovimin e tij janë shpjeguar në Statutin e UBT. Pika 1, Neni 59 shprehet se “UBT kryen veprimtari kërkimore-shkencore në fusha të tilla si ... <i>mbarëshkrimin e pyjeve; industri e drurit...</i>”.</p> <p>Veprimtaria kërkimore-shkencore realizohet përmes, studimeve, projekteve për zhvillim, si dhe veprimtarive të tjera krijuese dhe UBT garanton integrimin e veprimtarisë kërkimore në atë të mësimdhënies.</p> <p>Po kështu, edhe Plani Strategjik i UBT 2016-2025 paracakton veprime të qarta në mbështetje të kërkimit shkencor në nivel institucional.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>UBT ka miratuar rregulloren e etikës në kërkimin shkencor (Aneks 62), ku shprehet qartë, se cilat raste konsiderohen shkelje të kodit të etikës si edhe masat dhe qëndrimet që duhen mbajtur. Në nenin 62 parashikohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkimi shkencor në UBT realizohet në përputhje me parimet universale të kodit etik të shkencëtarit. 2. UBT ndëshkon praktikën korruptive të konfliktit të interesit në kërkimin shkencor dhe plagjiaturës në kërkim e publikimin e rezultateve.

<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>GVJ zhvilloi takime me stafin akademik të Departamentit të Pyjeve (DP) dhe Dekanantin e FSHP. GVJ u informua mbi mbështetjen e kërkimit tek studentët që zhvillohet kryesisht nëpërmjet konferencave studentore (Aneks 83. Thirrje për konferencë) të organizuara dhe të mbështetura financiarisht nga UBT dhe FSHP (Nënkapitulli 4.4. Pjesëmarrja e studentëve në kërkim. Plani Strategjik i UBT 2016-2025).</p> <p>Përveç kësaj, studentët e ciklit Master Shkencor në DP marrin pjesë në kërkim nëpërmjet punimeve të mikrotezave që ata realizojnë nën udhëheqjen e profesorëve.</p>			
---	--	--	--	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVB konfirmon se program i studimit është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuar në kredite sipas ECTS. Shuma e krediteve të grumbulluara gjatë një viti, nga një student në ciklin e dytë të studimeve është 60 kredite (Aneks 12. Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore 2014-2016).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Në përputhje me Planin Mësimor të Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore (Aneks 12) , programi synon përgatitjen e specialistëve në fushën e pyjeve të aftë nga pikëpamja profesionale e shkencore të mbarështrajnë në mënyrë të integruar burimet pyjore, duke siguruar kështu një zhvillim të qëndrueshëm të tyre nga pikëpamja ekologjike, ekonomike e sociale.</p> <p>Kurrikula e këtij programi (Aneksi 13) konfirmon sa më lartë. Lëndët e zhvilluara përfshijnë ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjeobotanikë • Përmirësim gjenetik i llojeve pyjore • Inventarizim i Pyjeve • Ekonomi e burimeve natyrore • Dendrokronologji • Tipologji pyjore • Statistika pyjore • Teknika të rrallimit të pyjeve të rinj • Histori pyjore • Gjuhë e huaj • Kadastër pyjore dhe GIS • Shfrytëzim ekologjik i pyjeve • Ripopullim dhe introduksione të kafshëve të egra • Tregje dhe Marketing i produkteve pyjore • Vlerësim i ndikimeve mjedisore në pyje
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi (Aneksi 13) tregon se studentët marrin njohuri të përparuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjeobotanikë • Përmirësim gjenetik i llojeve pyjore • Inventarizim i Pyjeve • Ekonomi e burimeve natyrore • Dendrokronologji • Tipologji pyjore • Statistika pyjore • Teknika të rrallimit të pyjeve të rinj • Histori pyjore • Kadastër pyjore dhe GIS
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të</p>	<p>Kurrikula e këtij programi (Aneksi 13) tregon se studentët marrin njohuri të përparuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjeobotanikë • Përmirësim gjenetik i llojeve pyjore • Inventarizim i Pyjeve • Ekonomi e burimeve natyrore • Dendrokronologji • Tipologji pyjore • Statistika pyjore • Teknika të rrallimit të pyjeve të rinj • Histori pyjore • Kadastër pyjore dhe GIS

<p>nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shfrytëzim ekologjik i pyjeve • Ripopullim dhe introduksione të kafshëve të egra • Tregje dhe Marketing i produkteve pyjore • Vlerësim i ndikimeve mjedisore në pyje <p>Njohuritë e përfuara në këtë program janë të vlefshme për punësim në institucione, organizata menaxhimi, nisma private etj.</p> <p>Programi siguron të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. Nëpërmjet këtij programi studimi studentët aftësohen në aplikimin e metodave të kërkimit shkencor dhe i përdorin ato në mënyrë të pavaruar në kërkimin pyjor, drejtojnë në mënyrë të integruar e të qëndrueshme proceset e prodhimit në pyje dhe vlerësojnë në mënyrë të plotë ndikimet e tyre në ekosistemet pyjore.</p> <p>Studentët aftësohen të ofrojnë në nivel të lartë asistencë teknike dhe profesionale për problemet e fushës së pyjeve. Kjo realizohet nëpërmjet orëve laboratorike, studimeve të fushave të ndryshme dhe praktikave kërkimore që zhvillohen gjatë semestrit të dytë në vitin e dytë të Programit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore.</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Pas shqyrtimit të Planit mësimor dhe kurrikulës së programit, GVJ konfirmon se Programi Master i Shkencor në Inxhinieri Pyjore, është i organizuar në dy vite, me total kreditesh 120. Programi ofron 13 module me një total orësh 1155 orë, të organizuara në leksione, seminare, ushtrime, punë laboratorike, praktika kërkimore.</p> <p>Program i studimit është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të parashtruara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë “</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në programin e studimit, modulet janë grupuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndë bazë 11 kredite (9.2%); • Lëndë karakterizuese 65 kredite (54.2%); • Lëndë ndërsiplinore 17 kredite (14.2%); • Lëndë plotësuese 12 kredite (10%) dhe • Detyrime përmbyllëse (12.4 %). <p>Mbështetur në sa më sipër GVJ konfirmon se Programi i studimit ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj.</p>	<p>GVJ konfirmon se realizimi i tezës së diplomës bëhet nëpërmjet sistemit të krediteve. Teza e diplomës është e organizuar në praktikë kërkimore me 7 kredite dhe përgatitja e tezës me 8 kredite. Pra në total realizimi i tezës së diplomës vlerësohet me 15 kredite.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

Standardi II.2**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ konfirmon se bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe verifikimin gjatë vizitës në institucion, si dhe shqyrtimit të Rregullores se Programit të Studimit në Master Shkencor Inxhinieri Pyjore (Aneksi 63), Departamenti i Pyjeve është njësi bazë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit. Departamenti është strukturë në përbërje të Fakultetit të Shkencave Pyjore.</p> <p>Ky institucion e ka kaluar procesin e akreditimit institucional sipas ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (2015). Detyrimet në nivelin e FSHP kanë të bëjnë me hartimin e politikave dhe sigurimin e cilësisë, të cilat shprehen në Rregulloren e Brendshme të FSHP 2017 (Aneksi 60).</p> <p>Njësia e sigurimit të cilësisë që vepron në nivel të UBT-së garanton cilësinë në procesin mësimor.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe shqyrtimit të tij gjatë vizitës në terren lidhur me funksionimin dhe veprimtarinë e saj, GVJ vërteton se njësi bazë i plotëson kushtet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur si në DVV dhe RVB shprehet se Departamenti i Pyjeve është njësi bazë dhe ky departament përmbush detyrimet lidhur me zbatimin e përcaktimeve ligjore dhe rregulluese për një program të tillë studimi të ciklit të dytë lidhur me aspektet organizative (personelin akademik, mjediset, sistemet funksionale të informimit dhe komunikimit, etj) dhe ato të përmbajtjes (ndërtimi i planit mësimor, kurrikulës, etj).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, Dekani i FSHP dhe përgjegjësi i DP kanë konfirmuar vlerësimin institucional të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me ligj për organizimin e programit mësimor përfshirë dokumentacionin në nivel universiteti UBT, Fakulteti (FSHP) dhe DP.</p> <p>Dokumentacioni përmban statutin e universitetit. Rregulloret e funksionit institucional dhe ato të lidhura me programin janë të hartuara dhe gjenden të afishuara në faqen e internetit të njësisë bazë.</p> <p>GVJ ka vlerësuar përmbushjen e detyrimit institucional të FSHP dhe DP si strukturat përgjegjëse për zbatimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Njësia bazë përmbush edhe kriterin e angazhimit të stafit akademik dhe atij mbështetës.</p> <p>Stafi akademik i Programit të studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore sigurohet nga DP (njësia bazë) dhe FSHP.</p> <p>DP përbëhet nga një personel mësimor, shkencor dhe mbështetës të plotë për nevojat e këtij programi. Në përbërje të stafit janë 14 personel akademik (7 me titull të kategorisë Profesor, 3 Profesor i Asociuar dhe 4 Doktor të Shkencave), dhe 6 punonjës mbështetës dhe administrativ.</p>

	<p>Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga 16 staf akademik me kohë të plotë dhe dy të ftuar , prej të cilëve një personel akademik nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (Aneks 2, Analiza e punës mësimore Departamenti i Pyjeve, viti akademik 2017-2018 dhe Aneks 3. Analiza e punës shkencore 2018).</p> <p>Shqyrtimi i CV të stafit akademik të DP (Aneks 11, CV-të akademike te stafit te programit te studimit) jep informacion se i tërë stafi akademik ka kryer ose është në proces kualifikimi për marrjen e titujve dhe gradave si dhe ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime të gjata dhe shkurtra jashtë vendit.</p>			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Departamenti i Pyjeve që është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave Inxhinieri Pyjore përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike në përputhje me L. 80/2015.			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Departamenti i Pyjeve është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit. Për realizimin e praktikave mësimore angazhohet 6 punonjës mbështetës.			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ u informua nga vizita në Departamentin e Pyjeve si dhe shqyrtimi i RVB se rolin e koordinorit të programit e mbulon përgjegjësi i departamentit i cili koordinon dhe ndjek ecurinë e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e këtij programi.			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Departamenti i Pyjeve është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin,	Departamenti i Pyjeve është njësia bazë përgjegjëse për programin. Njëkohësisht, kjo njësi është dhe propozuesja e programit. Njësia disponon gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion është i shprehur në disa prej anekseve e sidomos në:

strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Aneks 2. Analiza e punës mësimore Departamenti i Pyjeve, viti akademik 2017-2018 • Aneks 60. Rregullore e Brendshme e FSHP 2017 • Aneks 63. Rregullore e Programit të Studimit në Master Shkencor Inxhinieri Pyjore
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Në programin e studimit, përfshihen 16 module. Modulet janë grupuar në: <ul style="list-style-type: none"> • Lëndë bazë 11 kredite (9.2%); • Lëndë karakterizuese 65 kredite (54.2%); • Lëndë ndërsiplinore 17 kredite (14.2%); • Lëndë plotësuese 12 kredite (10%) dhe • Detyrime përmblyëse (12.4 %).
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave Inxhinieri Pyjore, ka në total 120 kredite. Viti i parë ka 60 kredite, me nga 30 kredite secili semester.</p> <p>Viti i dytë ka 60 kredite, me nga 30 kredite secili semester. Në semestrin e parë të vitit të dytë zhvillohen 6 module me 30 kredite në total. Në semestrin e dytë të vitit të dytë studimi tematik është vlerësuar me 15 kredite, praktika kërkimore 7 kredite dhe mbrojtja e tezës 8 kredite.</p> <p>Mbështetur në sa më sipër GVJ konfirmon se Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Programi është i organizuar në lëndët dhe module të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendas dhe evropian dhe të ndara në dy vite dhe katër semestra.</p>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	GVJ shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur në Aneksin 15. Plani mësimor i programit të studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore viti akademik 2016-2019. Pas kësaj, GVJ konfirmon se ky plan përmban informacion për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.
Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Programi i studimit i jep të drejtën për t'u regjistruar individëve që kanë fituar diplomën e nivelit të parë Bachelor/Master profesional sipas kriterit të meritës, kriterit të rëndësisë, kriteri i gjuhës së huaj dhe kuotave të përcaktuara nga FSHP.</p> <p>Kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit, kryhen sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e FSHP dhe rregulloren e programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e brendshme FSHP-2017 • Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave "Inxhinieri Pyjore", • Rregullore e brendshme FSHP-2017, • Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave "Inxhinieri Pyjore"

<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ shqyrtoi syllabus-et e paraqitura në Anekset 16, 16.1, 17 dhe 17.1. Pas këtij shqyrtimi GVJ konfirmon se programi i studimit përmban plotësisht informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Syllabus-et janë në përputhje me formatet e miratuara.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Kurrikula e programit nuk ka ndryshuar që prej vitit 2008, që përkon me themelimin e programit. Kjo u konfirmua edhe nga takimi me Dekanin e FSHP dhe Përgjegjësin e Departamentit të Pyjeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konfirmon, nisur nga shqyrtimi i DVB për Programin e studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore, se programi është i strukturuar me një ngarkesë sipas normimit juridik të përcaktuar. Ai përmban 120 kredite të shtrira në dy vite mësimore, me dy semestra në çdo vit, me ngarkesë prej 60 kreditesh në çdo vit mësimor (ose afërsisht 30 kredite për çdo semestër).</p> <p>Sa më sipër gjendet e shprehur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e brendshme FSHP-2017 • Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Pyjore”, • Rregulloren e brendshme FSHP-2017, • Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Pyjore”
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ shprehet, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe njohjen e zbatueshmërisë së tij gjatë vizitës në institucion, se programi i studimi në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor Inxhinieri Pyjore përmban lëndë të emërtuara dhe kategorizuara në lidhje me emërtimin e të gjithë programit. Lëndët synojnë të ofrojnë njohuri dhe aftësi për ti krijuar studentëve mundësinë për studime të tjera më</p>

	<p>të thelluara në ciklin e tretë dhe punësim në institucine qendrore, institucione vendore, kompani private etj.</p> <p>Ky informacion konfirmohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneksin 13. Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave Inxhinieri Pyjore • Aneksin 15. Plani mësimor i Programit të Studimit Master i Shkencave Inxhinieri Pyjore 2018-2019
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>RVB argumenton se shpërndarja e lëndëve dhe moduleve në vite dhe semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Analizimi i kurrikulës nga ana GVJ, tregon se lëndët dhe modulet janë formuese, janë të shpërndara në mënyrë të ekuilibruar dhe nuk shkaktojnë ngarkesë të tepruar tek studentët. Takimi me studentët nuk solli vërejtje për programin nga pikëpamja e shpërndarjes së lëndëve.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit përputhet me profilin e programit master dhe është e përafërt me programe si-motra në vende të tjera e vecanërisht në Gjermani. Programi master shkencor Inxhinieri Pyjore pranë Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Eberswalde – Gjermani ka shërbyer si model për afrimi të kurrikulës.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konfirmon se raporti midis formimit teorik dhe praktik i shprehur në Aneks 17 (Syllabusët sipas modelit të VKM 41, date 24.01.2018) është në masën e duhur dhe mundëson arritjen e objektivave formues sikundër dhe transferimin e studimeve, mobilitetet dhe punësimin në përfundim të studimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabusët (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabus-et janë përshtatur vazhdimisht me formatin e kërkuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe janë konform këtyre përcaktimeve ligjore. Syllabus-et rishikohen për cdo vit për tu pasuruar me informacione shtesë dhe me literaturën përkatëse bazë të detyrueshme dhe atë ndihmëse. Kjo më sipër konfirmohet nga shqyrtimi dhe krahasimi i syllabus-ve të paraqitura në anekset:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks 16. Syllabusët e modeleve të mëparshme • Aneks 17. Syllabusët sipas modelit të VKM 41, date 24.01.2018
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi (Aneksi 13) tregon se studentët marrin njohuri të përparuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjeobotanikë • Përmirësim gjenetik i llojeve pyjore • Inventarizim i Pyjeve • Ekonomi e burimeve natyrore • Dendrokronologji • Tipologji pyjore • Statistika pyjore • Teknika të rrallimit të pyjeve të rinj

	<ul style="list-style-type: none"> • Histori pyjore • Kadastër pyjore dhe GIS • Shfrytëzim ekologjik i pyjeve • Ripopullim dhe introduksione të kafshëve të egra • Tregje dhe Marketing i produkteve pyjore • Vlerësim i ndikimeve mjedisore në pyje <p>GVJ konfirmon se kurrikula e mësipërme e programit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>								
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ vëren se kurrikula e mësipërme e programit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë pranë Departamentit të Pyjeve apo edhe në programe të tjera të ngjashme të ciklit të tretë të fushës së Mjedisit ndonëse ky cikël pranë UBT është për momentin i ndërprerë.</p> <p>Në vijim, takimi me Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA) dhe Zyra e Karrierës së Studentëve (ZKS) informoi GVJ mbi punësimin e studentëve të këtij programi në Autoritetet Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Bashki, institucione kërkimore të vendit dhe të huaja si dhe në institucione politikë-bërëse si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.</p>								
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Pyjeve në kuadër të FSHP-së ka zhvilluar kurrikulat e tri programeve të saj me eksperiencën e universiteteve europiane e sidomos me Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Eberswalde - Gjermani, si rezultat i të cilit është bërë përafrimi i kurrikulës.</p> <p>Ndërkaq kurrikula nuk ka pësuar ndryshime që prej vitit 2008.</p>								
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>GVJ vëren se kurrikula e mësipërme e programit mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve pranë Departamentit të Pyjeve apo edhe në programe të tjera të ngjashme të ciklit të tretë të fushës së Mjedisit ndonëse ky cikël pranë UBT është për momentin i ndërprerë.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			✓	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		✓							

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga 16 staf akademik me kohë të plotë dhe dy të ftuar, prej të cilëve një personel akademik nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (Aneks 2, Analiza e punës mësimore Departamenti i Pyjeve, viti akademik 2017-2018 dhe Aneks 3. Analiza e punës shkencore 2018).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i Programit të studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore sigurohet nga DP (njësia bazë) dhe FSHP.</p> <p>DP përbëhet nga personeli mësimor, shkencor dhe mbështetës. Në përbërje të stafit janë 14 personel akademik (7 me titull të kategorisë Profesor, 3 Profesor i Asociuar dhe 4 Doktor të Shkencave), dhe 6 punonjës mbështetës dhe administrativ.</p> <p>Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga 16 staf akademik me kohë të plotë dhe dy të ftuar, prej të cilëve një personel akademik nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (Aneks 2, Analiza e punës mësimore Departamenti i Pyjeve, viti akademik 2017-2018 dhe Aneks 3. Analiza e punës shkencore 2018).</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Shqyrtimi i CV të stafit akademik të DP (Aneks 11, CV-të akademike të stafit të programit të studimit) jep informacion se i tërë stafi akademik ka kryer ose është në proces kualifikimi për marrjen e titujve dhe gradave si dhe ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime të gjata dhe shkurtra jashtë vendit.</p> <p>Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është tërësisht në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Praktikat profesionale të zhvilluara lidhen me punën për temën e diplomës së programit në përfundim të studimeve. GVJ konfirmon se secili prej studentëve të programit të ciklit të dytë ka udhëheqësin e vet. Nga ana tjetër, duket se nuk ka mbingarkim të pedagogëve që të mund të çonte detyrimisht në drejtim të pamjaftueshëm të studentëve. Numri i lartë i stafit akademik me gradën shkencore Doktor i Shkencave, Profesor i Asociuar dhe Profesor garanton shpërndarje të drejtë të ngarkesës.</p> <p>Vec kësaj zhvillimi i Panairit të Karrierës ka krijuar kontakte të drejtpërdrejta të studentëve të viteve të fundit me institucionet publike e private.</p> <p>Institucioni organizon çdo vit Panairin e punës – në nivel universiteti, me pjesëmarrjen e kompanive dhe firmave të ndryshme. Studentët plotësojnë formularë interesi dhe kompanitë private pjesëmarrëse prezantojnë mundësitë e tyre të punësimit. FSHP ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura si dhe me Agjensinë Kombëtare të Mjedisit, për realizimin e praktikave profesionale si dhe kërkimin për të përgatitur Punimin e Diplomës në mbyllje të Masterit Shkencor.</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>GVJ, nisur nga vizita në insitucion dhe shikimi i CV-ve të stafit të angazhuar në mbarëvajtjen e programit, konfirmon se zhvillimi i seancave laboratorike në këtë program kryhet nëpërmjet angazhimit të stafit akademik ndihmës shkencor që përbëhet nga gjashtë persona që përkujdesen për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. Tek laboratorët përfshihen Laboratori i GIS, Laboratori i Dendrokronologjisë dhe Laboratori i Botanikës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Sikurse thënë më parë, kurrikula e programit nuk ka ndryshuar që prej vitit 2008. Ndërkaq, takimet me stafin e Departamentit të Pyjeve dhe Dekanatin e FSHP konfirmojnë se përmbajtja e programit të studimit është e përshtatur me kërkesat e tregut e punës. Në hartimin e saj, kurrikula e programit ka marrë parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> <p>Në shtesë, Zyra e Karrierës konfirmoi pranë GVJ se nuk ka pasur kërkesa specifike nga kompanitë private që kanë marrë pjesë në Panairin e punës, lidhur me formimin specifik të studentëve në këtë program.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimin të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional pranë të cilit funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është njësia e posaçme përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit.</p> <p>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor në nivel universiteti i raporton senatit mbi vlerësimin dhe rishikimin e programeve të studimit.</p> <p>Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor në fakultet shqyrton paraprakisht propozimet për ndryshimin/rishikimin e kurrikulave dhe programit mësimor. Departamenti është përgjegjës për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin e kurrikulave.</p> <p>Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri pyjore nuk ka pësuar ndryshime që nga viti 2008. Gjithashtu në takimin me studentët u pohua se ata nuk janë përfshirë në diskutime për përmirësimin e kurrikulës. Ata sugjeruan se kurrikula mund të përmirësohet më tej për të shmangur ngjashmëritë midis moduleve</p>




	të trajtuara në ciklin e parë të studimeve apo dhe midis moduleve të trajtuar në ciklin e dytë.			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	UBT ka krijuar, në vitin 2017, Degën e Informimit, të Orientimit dhe të Karrierës së Studentëve e cila është funksionale dhe ka në varësi Qendrën e Karrierës dhe Alumnit (QKA). Kjo qendër ka specialistë të dedikuar për të ndjekur ecurinë e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve. Megjithatë, krijimi i vonët i QKA dhe fakti që kurrikula nuk ka ndryshuar që prej vitit 2008 dëshmojnë se kontaktet dhe këshillimi me studentët e diplomuar nuk kontribuon sot për sot në përmirësimin e programit të studimit. Po kështu RVB nuk sjell argumente mbështetëse që të dëshmojnë këshillimin dhe përmirësimin e programit të studimit.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Kurrikula nuk ka ndryshuar që prej vitit 2008, gjë që dëshmon se programi nuk ka pësuar përditësim, përshtatje dhe riorganizim të programeve të posaçme me fushë specifike studimin dhe kërkimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	UBT ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushat: prodhim bimor, prodhim shtazor; hortikulturë; mbrojtje bimësh; akuakulturë dhe peshkimi; agromjedis & mbrojtjen e tij; ekonomi agrare; politikat bujqësore; zhvillimi i interguar rural; mmenaxhimi i ndërmarrjeve; marketing; financë & kontabiliteti; agroturizëm, bioteknologji dhe ushqim; industrinë e pijeve; mbarëshkrimin e pyjeve; industrinë e drurit; mjekësinë veterinarë & shëndetin publik etj. Plani Strategjik shpjegon aktivitetin kërkim-shkencë në FSHP si dhe shpjegon fushat e veprimit të këtij fakulteti. Analiza e punës shkencore 2018 (Aneksi 3.) tregon mbi ekzistencën e pesë grupeve kërkimore që funksionojnë brenda organizimit institucional dhe kuadrit të punës së Departamentit të Pyjeve: <ul style="list-style-type: none"> • Grupi mësimor-kërkimor i Silvikulturës • Grupi mësimor-kërkimor i Botanikës • Grupi mësimor-kërkimor i Mbarështrimit dhe Matjes së Pyjeve • Grupi mësimor-kërkimor i Ekonomisë dhe Politikave Pyjore

	<ul style="list-style-type: none"> • Grupi mësimor-kërkimor i Teknologjisë së Shfrytëzimit të Pyjeve
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Aneksi 3 paraqet në detaje fushat kërkimore brenda Departamentit të Pyjeve që është njëkohësisht dhe njësia përgjegjëse për Programin Master Shkencor Inxhinieri Pyjore.</p> <p>Fushat e kërkimit të këtij departamenti janë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strategjitë e zhvillimit të sektorit të pyjeve • Rigjenerimi i sipërfaqeve të degraduara të dushqeve. • Kontributi i tipeve të vegjetacionit pyjor në fiksimin e CO2. • Sistemet e mbrojtjes nga erozioni. • Metodatat e luftës biologjike ndaj dëmtuesve në pyje. • Praktikat më të mira të mbarështrimit të qendrueshëm të pyjeve. • Studimi i potencialeve të prodhimit të biomasës pyjore për bioenergji. • Sistemet e rrallimeve dhe teknikat e punës gjatë ndërhyrjeve. • Vlerësimi i impakteve mjedisore të punimeve në pyje. • Funkcionimi i tregjeve të produkteve pyjore e drusore. • Vlerësimi monetar i shërbimeve mjedisore nga pyjet. • Studimi i mundësisë së krijimit të plantacioneve me lloje me rritje të shpejtë për energji. • Studimi i dëmtimeve nga zjarret në pyje dhe masat për rehabilitimin e tyre. • Vlerësimi ekonomik i kontributit të pyjeve në jetesën e komuniteteve në zonat rurale. • Studimi i kapaciteteve prodhuese për produktet jo drusore dhe shfrytëzimi i tyre. • Përcaktimi i standarteve të punës në operacionet pyjore. <p>Liria akademike e personelit shprehet brenda fushave të mësipërme të kërkimit.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Sudentët angazhohen në kërkim kryesisht në kuadër të punës për realizimin e temave të diplomës.</p> <p>Përtej diplomës angazhimi i studentëve në studime, projekte dhe aktivitete të tjera kërkimore mbetet jo i plotë. Sa më sipër u pohua gjatë takimit të GVJ me studentët e programit në shqyrtim.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Temat kërkimore-shkencore të programit të studimit janë paraqitur më lartë, në Kriterin 2 të Standartit II.7. Bazuar në këto tema, GVJ është i mendimit se programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Sikursë parashtruar dhe më parë, RVB pohon se ka një rritje në buxhetin për kërkimin por pa dhënë shifra argumentuese. Për më tepër analiza SWOT e kryer në kuadër të Vlerësimit të Punës Kërkimore Shkencore për Vitin 2018 (Aneks 3) pohon se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Grupet kërkimore-mësimore kanë karakter formal, • Infrastruktura laboratorike nuk i përgjigjet nivelit të kërkimit,

	<ul style="list-style-type: none"> • Puna në laboratorët e fakultetit është e fragmentarizuar dhe aspak e konsoliduar <i>dhe</i> • Mungojnë fondet për kërkimin. <p>Sa më sipër u konfirmua dhe nga diskutimet e zhvilluara me Dekanatin, GVB dhe stafin e Departamentit të Pyjeve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi II.8				
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	RVB nuk përpiqet të argumentojë përmbushjen e këtij kriteri dhe nuk tregon sesi institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	RVB nuk përpiqet të argumentojë angazhimin e njësisë përgjegjëse për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	GVJ pohon se vetë UBT ka mbështetur dhe organizuar konferenca, workshope dhe aktivitete kombëtare e ndërkombëtare të shumta. GVJ u informua mbi konferencat studentore (Aneks 83. Thirrje per konferencë) të organizuara dhe të mbështetura financiarisht nga UBT dhe FSHP (Nënkapitulli 4.4. Pjesëmarrja e studentëve në kërkim. Plani Strategjik i UBT 2016-2025). Përvec kësaj, studentët e ciklit Master Shkencor në DP marrin pjesë në kërkim nëpërmjet punimeve të mikrotezave që ata realizojnë nën udhëheqjen e profesorëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	RVB nuk dëshmon mbi ekzistencën e një udhëzuesi specifik në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Megjithatë, në DVV është vendosur Udhëzuesi në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies (Aneksi 86).			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademi.	UBT ka themeluar Degën e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional. Misioni i saj veç funksioneve të tjera është koordinimi dhe monitorimi i gjithë procesit mësimor, si edhe proceseve të vetëvlerësimit të të gjitha njësive të UBT. Gjithashtu, në Fakultetin e Shkencave Pyjore) ekziston struktura specifike që realizon koordinimin dhe monitorimin e të gjithë procesit mësimor, si edhe proceseve të vetëvlerësimit të Njësive bazë. Kjo strukturë udhëhiqet nga Zëvendësdekani për mësimin.			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	GVJ konfirmon se institucioni ka hartuar një pyetësor të vecantë (Aneksi 20. Forma e pyetësorit) lidhur me vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. Trajtimi i ankimimeve është kryer nëpërmjet Raporteve të anketimit 2017 dhe 2018 (Aneks 55 dhe 55.1). Këto raporte janë publike.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.				
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Institucioni duhet të tregojë se si promovohen shembujt e praktikave të mira dhe si nxitet personeli akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të	GVJ konfirmon se DP dhe personeli akademik i përfshirë në zbatimin e programit të studimit përdor një gamë të gjerë formash të

<p>dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>mësimdhënies sikurse leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat mësimore dhe profesionale. Gjatë takimit me stafin akademik dhe kordinatorin e programit të studimit u theksua se vëmendje e veçantë i kushtohet pjesës praktike (kryesisht punës në laborator) për të rritur aftësitë praktike të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>GVJ pohon se puna mësimore me studentët e ciklit të dytë “Master Shkencor”, përfshin një larmi formash të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijeve të parashikuara në planet mësimore dhe syllabus-et e moduleve. Studentët konfirmojnë se stafi i Departamentit të Pyjeve që mbulon këtë program studimi është i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar udhëzues për personelin akademik që të zhvillojë aftësitë e veta lidhur me përdorimin e teknologjive të reja të komunikimit (Aneksi 86). Mundësia e përdorur më shpesh është përfshirja në Marrëveshjet e Bashkëpunimit me institucionet homologe jashtë vendit, ku një numër i madh anëtarësh të personelit akademik kanë përfutur mobilitete dhe kanë marrë pjesë në aktivitete shkëmbimi. Zyrat e Sekretarisë dhe ajo e Karrierës dhe Alumni informojnë mundësitë e shkëmbimit, përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve apo veprimtarive formuese. Gjithashtu studentët informohen edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit apo faqeve personale (në internet) të pedagogëve.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik përbëhet nga tetë Profesorë, dy Profesorë të Asociuar dhe tre pedagogë me gradën “Doktor i Shkencave”. Stafi është tërësisht i kualifikuar si rezultat i bashkëpunimeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. GVJ konfirmon se DP dhe personeli akademik i përfshirë në zbatimin e programit të studimit përdor një gamë të gjerë formash të mësimdhënies si leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat mësimore dhe profesionale.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni ka hartuar një pyetësor të vecantë (Aneksi 20. Forma e pyetësorit) që u shpërndahet studentëve lidhur me vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Trajtimi i ankimimeve është kryer nëpërmjet Raporteve të anketimit 2017 dhe 2018 (Aneks 55 dhe 55.1). Këto raporte janë publike.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe</p>	<p>GVJ, mbështetur në vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies si dhe në diskutimet me studentët, është i mendimit se ka vend për përmirësim të mëtejshëm të autonomisë së studentit. Trajtimi i moduleve me tekste alternative do ta përforconte sensin e autonomisë së studentëve.</p>

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ pohon se procesi mësimor për programin e studimeve Master i Shkencave, zhvillohet në hapësira të mjaftueshme për numrin e student. Procesi zhvillohet në mjediset të Fakultetit të Shkencave Pyjore dhe përkatësisht në dy salla leksionesh dhe katër laboratorë.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Vizita në mjediset e dedikuara për mësimdhënie tregoi se mjediset janë të pajisura me mjetet e nevojshme të përshtatshme si kompjutera, videoprojektorë, lidhje interneti, ngrohje të vecantë etj. Mjediset plotësojnë kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 2.5 m ² /student.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	GVJ vizitoi mjediset dhe konfirmon se studentët dhe stafi akademik shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar, IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. Veçanërisht i pajisur është laborator i GIS-it që u vjen në ndihmë të gjithë studentëve në punën gjatë procesit mësimor.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	Shqyrtimi i DVV (syllabuset e lëndëve) si dhe takimi me stafin e programit të studimit, mundëson GVJ të konfirmojë së çdo lëndë ka literaturën e sugjeruar bazë dhe ndihmëse. Ajo ofrohet në formën e librave të shtypur të cilët janë dispozicion të studentëve në mjedise të përcaktuara të UBTsë. Gjithashtu literatura ndihmëse apo ajo në shërbim të elementëve pjesorë (tema seminaresh, detyrash kursi, etj) ofrohet si informacion digjital (version pdf ose faqe interneti) ose përmes bibliotekës së UBTsë. Gjatë vizitës në UBT, GVJ vëzhgoi edhe mjediset e Bibliotekës Shkencore "Mentor Përmeti". Biblioteka ka një fond prej 30,000 librash dhe revista në gjuhën shqipe dhe të huaja për fusha të ndryshme studimi si dhe 5,000 volume periodiku (shqip dhe të huaj).
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka ka gjithashtu sallën me 12 kompjuterë desktop të lidhur me internet nëpërmjet të cilëve mund të shfrytëzohet fondi online TEEAL aplikuar në UBT. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe burime të tjera online pa pagesë (p.sh., Google site; MOODLE, Research4life me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI,
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	

	<p>GOALI). Salla e kompjuterëve shfrytëzohet nga studentët edhe për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit sipas programeve të studimit</p> <p>Bazuar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit, biblioteka harton planin për shtimin e fondit të saj me tituj të rinj apo abonime në revista shkencore.</p> <p>Gjatë takimeve me studentët dhe stafin akademik u theksua se përdorimi i burimeve të bibliotekës rritej gjatë sezonit të provimeve apo kur studentëve u jepeshin detyra konkrete.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ vëzhgoi nga afër infrastrukturën laboratorike të nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike.</p> <p>Mbështetur në këtë vizitë, GVJ konfirmon se infrastruktura është e përshtatshme dhe mund të shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. Veçanërisht i pajisur është laboratori i GIS-it që u vjen në ndihmë të gjithë studentëve në punën gjatë procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ pohon se institucioni është angazhuar në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit për përmirësimin e mësimdhënies dhe kualifikimin e mëtijshëm të stafit. Disa nga instrumentet që përdoren përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • E-learning - siguron zëvendësimin e materialeve të shtypura me versione elektronike si dokumente, materiale të bashkëngjitura, prezantime poëer-point, audio, video, teste, forume, animacione etj; • Moduli online “Njohuria mbi informacion” - Studenti mëson se si të gjejë informacionin e duhur që u shërben për të shkruar një detyrë/punë shkencore, duke shfrytëzuar tre llojet e burimeve të informacionit; • TEEAL - Biblioteka Themelore Elektronike Bujqësore si bazë të dhënash me tekste të plotë të artikujve nga më shumë se 450 revista kërkimore, me cilësi të lartë në fushën e bujqësisë dhe në shkencat e lidhura me të.
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga diskutimi me stafin akademik të Departamentit si dhe nga shqyrtimi i DVV-se del në pah se institucioni përdor sistemet e komunikimit të brendshëm si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Platforma "E-learning" - Metodë inovative ku materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike; • Google Site – Faqe dinamike, ku çdo pedagog i UBT-së ngarkon dhe azhuron në mënyrë të vazhdueshme tekste, prezantime poëer-point, video dhe audio lidhur me fushën e studimit, lëndëve/moduleve përkatëse; • Esse3 - program i Ministrisë Përkatëse për Arsimin është një sistem i integruar për menaxhimin e shërbimeve për studentët

	ku studenti mund të monitorojë studimet e tij përmes një kodi unik identifikimi			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	<p>Në përfundim të studimeve, studentët e Masterit Shkencor Inxhinieri Pyjore janë të detyruar të kryejnë dhe të paraqesin studimin për temën e përzgjedhur të diplomës.</p> <p>Kriteret dhe standartet e përgatitjes së një punimi diplome të nivelit të dytë “Master Profesional” përcaktohen nga Departamenti.</p> <p>Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temës bazuar në fushat e kërkimit që mbulon departamenti.</p> <p>Për çdo student ka një pedagog udhëheqës me gradën shkencore Doktor i Shkencave, Profesor i Asociuar dhe Profesor.</p> <p>Studentët në bashkëpunim dhe me miratimin e udhëheqësit plotësojnë një formular ku specifikojnë fushën e studimit / titullin potencial të temës.</p> <p>Udhëheqësi i punimit të diplomës (personeli akademik) përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përfaqëruara të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë.</p> <p>Hapat e mësipërm janë të përcaktuar në Nenin 37. Diplomimi i studentëve të programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" të Rregullores së brendshme të Fakulteti të Shkencave Pyjore (Aneksi 60) dhe në Kreu VII. Diplomimi i studentëve në rregulloren mësimore të programeve të studimit “Master Shkencor” Profili: Inxhinieri Pyjore (Aneksi 63).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>GVJ konfirmon se në UBT ekzistojnë strukturat e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave & Vlerësimit Institucional • Sektori i Kërkimit, Kooperimit Shkencor & Projekteve • Sektori i Informacionit & Transferimit të Njohurive. <p>GVJ konfirmon se Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, në nivelin e UBTsë vlerëson në mënyrë të rregullt, në</p>

	<p>periudha vjetore, përmes përfshirjes së studentëve me anë të një pyetësoari.</p> <p>Çdo fillim viti akademik, SZKV përgatit një komunikim për të gjitha njësitë, duke udhëzuar lidhur me strukturën dhe organizmin e procesit mësimor në atë vit akademik.</p> <p>Struktura e vlerësimit të cilësisë është e ndërtuar edhe në nivel Fakulteti, pranë FBM.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneksi 37: Manual i cilësisë në UBT 2018 • Aneksi 66: Rregullore e studimeve universitare • Aneksi 60: Rregullore e brendshme e FSHP
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të punës së DP dhe përmes pyetësorëve me studentët të organizuar në nivel UBT (prej Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional), vlerësohet në mënyrë të rregullt, të përvitshme, niveli dhe aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik të këtij programi studimi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ është informuar mbi procedurën e ndjekur prej këtij sektori dhe mbi shkallën e performancës për çdo lëndë në këtë program. Të dhënat e vlerësimit vihen në dispozicion të përgjegjësit të DP për tu diskutuar më pas me secilin personel akademik.</p> <p>Të gjitha këto shkëmbime experience i shërbejnë ndër të tjera edhe rritjes së vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ pohon se gjatë takimeve me stafin akademik, sikundërse referohet edhe në RVB, janë cituar një numër leksionesh të hapura nga pedagogë të njësisë bazë apo edhe të ftuar. Ndonëse nuk ka një listë të shprehur qartë me data, vendin dhe lektorin, kjo praktikë është referuar në disa raste.</p> <p>Sikundërse është pohuar prej GVJ, kualifikimi i stafit akademik është kryer kryesisht përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe aktivitete shkëmbimi me institucione homologe jashtë vendit.</p> <p>Si tregues të ecurisë shërbejnë analiza e punës shkencore dhe analiza e punës mësimore paraqitur përkatësisht në Aneksin 1, Aneksin 3 dhe Aneksin 2.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Vizita në Departamentin e Pyjve dhe shqyrtimi i DVV-së tregojnë se kualifikimi i stafit akademik është kryer kryesisht përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe aktivitete shkëmbimi me institucione homologe jashtë vendit.</p> <p>Si tregues të ecurisë shërbejnë botimet shkencore dhe lista e programeve të shkëmbimit ku stafi i DP ka marrë pjesë.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Kjo konfirmohet në një sërë aneksesh:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks 1. Aktiviteti shkencor në 5 vitet e fundit • Aneks 3. Analiza e punës shkencore 2018 • Aneks 11. CV akademike të stafit të programit të studimit • Aneks 22. Formularët e performancës së pedagogëve

<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Rregulloret e Njesisë bazë dhe të programit të studimit shprehin qartë përgjegjësinë ligjore dhe funksionale të stafit të DP për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ato përcaktojnë si detyrë funksionale të personelit të DP arritjen e objektivave më të lartë në cilësinë e punës mësimore dhe shkencore.</p> <p>GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të kryer çdo vit nga DP për ecurinë e zbatimit të programit të studimit, kryhet vlerësimi i metodave të reja, nëse ka pasur, dhe stimulohet futja dhe përdorimi i tyre kur vlerësohen të efektshme. Kështu, në takimin me stafin akademik është vlerësuar i efektshëm përfshirja e studentëve në detyra kursi dhe prezantime në grupe të vogla pune.</p> <p>Sa më sipër shprehet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks 2: Analizat e punës mësimore, Departamenti i Pyjeve, Viti akademik 2017-2018 • Aneks 60. Rregullore e brendshme e FSHP • Aneks 63. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore 			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ konfirmon se DP dhe personeli akademik i përfshirë në zbatimin e programit të studimit përdor një gamë të gjerë formash të mësimdhënies si leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat mësimore dhe profesionale.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe kordinatorin e programit të studimit u paraqit se vëmendje e veçantë i kushtohet pjesës praktike (kryesisht punës në laborator) për të rritur aftësitë praktike të studentëve. Studentët konfirmojnë se stafi i Departamentit të pyjeve që mbulon këtë program studimi është i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>UBT ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi e partneriteti me institucione të ngjashme që rrisin nga pikëpamja e cilësisë performancën e stafit akademik por dhe ngrejnë në një nivel më të lartë transmetimin e dijeve tek studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive,</p>	<p>Rregulloret e studimit shprehin qartë mënyrën e vlerësimit me provim ose në mënyrë të vazhduar.</p>

dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<ul style="list-style-type: none"> • Aneks 60. Rregullore e brendshme e FSHP • Aneks 63. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore <p>Plani mësimor (Aneksi 15. Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave Inxhinieri Pyjore (2016-2017,2017-2018,2018-2019)) paraqet qartë shpërndarjen e pikëve të fituara nga vlerësimi i vazhduar dhe ai në provimin përfundimtar.</p> <p>Nga ana tjetër sistemi on-line ESSE3 e mundëson informimin në kohë reale për rezultatet e testimit.</p>								
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Njohja e studentëve me mënyrën e vlerësimit është e përcaktuar në rregullore të ndodhë në fillim të ciklit të studimit dhe në fillim të cdo lënde kur pedagogu njeh studentin me programin e lëndës.</p> <p>Pedagogët në faqet e tyre personale në internet apo dhe nëpërmjet kontakteve direkt japin informacion të hollësishëm për studentët për progresin në lëndët e tyre. ZKS ndihmon studentët të orientohen në gjetjen e informacionit të nevojshëm në mënyrën më të përshtatshme.</p> <p>Së fundi, studentët vlerësoan se ndjehen mjaftueshmërisht të informuar përmes pedagogëve për detyrimet e tyre dhe mënyrën e operimit për çdo lëndë specifike.</p>								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	<p>Sikundërse referohet në RVB, dhe konfirmuar prej GVJ gjatë vizitës në institucion, vlerësimi i dijeve realizohet në formate të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim i vazhduar përmes kontrolleve të njohurive të marra gjatë procesit mësimor në periudha të ndërmjetme, • Detyra të kursit, të cilat janë individuale dhe përmbushen gjatë vitit mësimor dhe • Testim përfundimtar. <p>Mënyra e vlerësimit në testin final është me shkrim, me gojë ose në format të kombinuar.</p> <p>Kjo mënyrë vlerësimi është e shprehur në rregulloret e funksionit të institucionit dhe të programit të studimit dhe ju bëhet e ditur studentëve në fillim të programit mësimor të ciklit të dytë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks 63. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore • Aneks 17: Syllabuset e lëndëve 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë	Sikundërse referohet në RVB, dhe konfirmuar prej GVJ gjatë vizitës në institucion, vlerësimi i dijeve realizohet në formate të ndryshme:

<p>vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i vazhduar përmes kontrolleve të njohurive të marra gjatë procesit mësimor në periudha të ndërmjetme, • Detyrat e kursit, të cilat janë individuale dhe përbushen gjatë vitit mësimor <i>dhe</i> • Testimi përfundimtar. <p>Mënyra e vlerësimit në testin final është me shkrim, me gojë ose në format të kombinuar.</p> <p>Kjo mënyrë vlerësimi është e shprehur në rregulloret e funksionit të institucionit dhe të programit të studimit dhe ju bëhet e ditur studentëve në fillim të programit mësimor të ciklit të dytë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks 63. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore • Aneks 17: Syllabuset e lëndëve
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Sikundër referohet në RVB, institucioni nuk ka sisteme të vlerësimit elektronik. Forma e përdorur është ajo standarde e provimit “me gojë”. Informimi lidhur me rezultatet e provimit jepen në sistemin ESSE3.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rregullorja e FSHP (Aneks 60) përcakton ndërtimin e komisionit të provimit në Nenin 68 të saj.</p> <p>Rregullorja shprehet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për mësimin dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. 2. Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim, ose kur përgjegjësi i departamentit e gjykon, ai përcakton pedagogun që do ta zëvendësojë. Në rast pamundësie zëvendësimi, me propozim të dekanit dhe miratim të Rektorit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda pesë ditëve nga përfundimi i tij;
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Sikundër referohet në RVB, institucioni nuk ka sisteme të vlerësimit elektronik. Forma e përdorur është ajo standarde e provimit “me gojë”. Informimi lidhur me rezultatet e provimit jepen në sistemin ESSE3.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konfirmon se vlerësimi i dijeve shoqërohet me dhënien e komenteve nga ana e stafit akademik. Komentet jepen në momentin e korigjimit në rastin e provimeve ose komenteve të drejtpërdrejta në provimet me gojë në detyrat e kursit. Komentet ndihmojnë studentin në përmirësimin e njohurive dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin në këtë proces. Pas shfaqjes së rezultateve në sistemin ESSE3, studentët kanë një periudhën të caktuar ankimi që u jep sërish mundësinë të marrin komente shtesë nga vlerësuesit e dijeve.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Neni 95 i Rregullores së FSHP përcakton kopjimin si veprim të ndaluar që shoqërohet me penalitete.</p>

	<p>DP konfirmon seriozitetin në kryerjen e testimi përmes mos lejimit të futjes në provim të personave të jashtëm, respektimin e orarit dhe masave parandaluese për kopjimin.</p> <p>Rregullorja nuk shprehet për rastet e plagjiaturës ndonëse ajo tentohet të shmanget përmes komunikimit midis pedagogut dhe studentit. Institucioni nuk ka ende një mjet (software) vlerësues të plagjiaturës.</p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas pikës 4 të nenit 65 të Rregullores së FSHP, pedagogu i modulit i komunikon studentit të drejtën e futjes ose jo në provimin final dhe nivelin e pikëve në orën e fundit të mësimit.</p> <p>DP konfirmon seriozitetin në vlerësim bazuar mbi meritën e studentit.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, UBT ka ndërtuar një sistem për menaxhimin e informacionit online bazuar mbi platformën ESSE3. Ky sistem menaxhon gjithë informacionin dhe dokumentet e stafit akademik, ndihmës e administrativ.</p> <p>Përmes këtij sistemi studentët njihen me vlerësimin e tyre dhe kanë dy ditë kohë për të shprehur ankimitin e tyre në rast të një vlerësimi të padrejtë. Studentit i garantohet e drejta të njihet me vlerësimin dhe në rast opinionit të kundërt me vlerësimin mund të drejtohet Përgjegjësit të Njesisë bazë ose FSHP me një ankesë, e cila shqyrtohet prej tyre. Drejtuesi i njesisë bazë mund të ngrejë edhe një komision të vecantë për shqyrtimin e ankesave dhe rishikimin e provimit.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimit, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>GVJ ka konfirmuar në takimin me studentët se ata kanë të drejtën të ankimojnë vlerësimin kur e gjykojnë të padrejtë. Neni 72 i Rregullores së FSHP shprehet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studenti ka të drejtë të ankimojë në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 2 ditëve (48 orëve) pas shpalljes së rezultatit dhe i drejtohet dekanit të fakultetit. 2. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjësin e departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. 3. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentit është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, që studentit të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, pa përjashtur nga komisioni pedagogun e modulit, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi (Aneksi 13) tregon se studentët marrin njohuri të thelluara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjeobotanikë • Përmirësim gjenetik i llojeve pyjore • Inventarizim i Pyjeve • Ekonomi e burimeve natyrore • Dendrokronologji • Tipologji pyjore • Statistika pyjore • Teknika të rrallimit të pyjeve të rinj • Histori pyjore • Kadastër pyjore dhe GIS • Shfrytëzim ekologjik i pyjeve • Ripopullim dhe introduksione të kafshëve të egra • Tregje dhe Marketing i produkteve pyjore • Vlerësim i ndikimeve mjedisore në pyje <p>Njohuritë e përfuara në këtë program janë të vlefshme për aftësimin profesional, punësim në institucione, organizata menaxhimi, nisma private etj.</p> <p>Kurrikula ka 16 module ku dallohen lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Për vetë natyrën e programit, modulet e Masterit Shkencor Inxhinieri Pyjore ofrojnë njohuri të thelluara profesionale. Lëndët me karakter të përgjithshëm kryhen më shpesh në nivelin Bachelor. Megjithatë disa prej moduleve kanë karakter ndërveprues ndërsa të tjera janë të fokusuar në përdorimin e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Plani mësimor i programit Master Shkencor (Aneks 15) përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Disiplina ndërvepruese si Ekonomi e Burimeve natyrore, Tregjet e Marketingu ndërkombëtar të Produkteve Pyjore dhe Vlerësimi i ndikimeve mjedisore. 2. Disiplina të teknologjisë së informacionit si GIS, Praktika kërkimore etj <p>RVB nuk informon mbi zhvillimin e aftësive të veçanta në gjuhë të huaj.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Në javën e fundit të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Njëkohësisht, merret edhe informacion nga ana e studentëve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe</p>	<p>Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.</p>

orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Sa më sipër u konfirmua dhe nga takimi me studentët.			
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	RVB thekson se personeli akademik i brendshëm integron të reja të fundit të shkencës dhe teknologjisë në informacionin që u jep studentëve. RVB nuk informon për orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	GVJ vizitoi bazën laboratorike dhe konfirmon se për module të caktuara të kurrikulës, sikurse ai i Kadastrës pyjore dhe GIS, studentët i aplikojnë kompetencat në laboratorë kompjuterikë.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	RVB informon se studentët inkurajohen dhe vihen të punojnë në grupe prej tre apo katër studentësh, punë e cila materializohet në një detyrë/projekt kursi. Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instruktin grupin e studentëve në realizimin e detyrës së caktuar. Sa më sipër u konfirmua nga takimi me stafin akademik si dhe me studentët e programit.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	RVB informon se personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve dhe identifikon fushat dhe momentet që kanë nevojë për më tepër informacion dhe studim të metejshëm.			
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	RVB informon se idetë inovative bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema diplome, por edhe tema doktorature për kërkuesit e rinj në të ardhmen. Megjithatë, RVB thekson se burimet financiare për kërkimin shkencor janë të kufizuara.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Gjatë takimeve, GVJ u informua se Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione e subjekte të tjera, të cilat iu garantojnë studentëve kryerjen e praktikave mësimore dhe profesionale. Praktikrat profesionale lidhen me temat kërkimore të diplomës së Programit Master Shkencor Ixhinieri Pyjore. Studentët e Masterit të Shkencave nxiten të marrin pjesë në dhe të prezantojnë rezultatet kërkimore në konferenca të organizuara nga Universiteti/Fakultetet apo dhe në konferencat studentore të mbështetura nga UBT			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Procesi i diplomimit përmbyllet me mbrojtjen e tezës së diplomës.</p> <p>Rregullat e Diplomimit të studentëve janë publike dhe të përcaktuara në dy rregullore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Neni 37. Diplomimi i studentëve të programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" Rregullore e brendshme e FSHP (Aneks 60) dhe • Kreu VII. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore (Aneks 63).
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>GVJ konfirmon se anëtarët e stafit akademik në detyrën e udhëheqësit të diplomantit, ndihmojnë dhe udhëzojnë studentin në hartimin e metodologjisë duke përcaktuar qartë qëllimin, objektivat e studimit, rezultatet e pritura, ofrojnë burimet e informacionit, literaturën si dhe metodën që do përdoret për analizë.</p> <p>Pika 3 e Nenit 51 citon "Temat e diplomës udhëhiqen nga punonjësit mësimor-shkencor të Fakultetit që kanë titull ose gradë shkencore (së paku Master), nga punonjësit shkencorë të instituteve kërkimore që i përshtaten studimeve në FSHP idhe që kanë kualifikim të lartë, si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës përkatëse të diplomimit."</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sikurse thënë më parë, programi i studimit nuk parashikon finalizim të studimeve të nivelit të dytë me provim final, por me temë diplome. Kjo përcaktohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e brendshme e FSHP (Aneks 60) dhe • Rregulloren e Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore (Aneks 63).
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Përcaktimi i temave të diplomës dhe udhëheqësit e tyre, përzgjidhen nga studentët ose / dhe në bashkëpunim me pedagogët dhe miratohen në department.</p> <p>Sa më sipër përcaktohet në Nenin 50 të Rregullores së Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore (Aneks 63) ku thuhet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 3. Departamentet përcaktojnë listën e temave të diplomave në fillim semestrit të dytë për studimet e ciklit të dytë. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti dhe 4. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga përgjegjësi i departamentit.
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ pohon se Departamenti i Pyjeve dhe Fakulteti i FSHP vendosin në ndihmë të diplomantëve. gjithë infrastrukturën laboratorike dhe u krijojnë lidhjet institucionale me organet shtetërore, për t'ju mundësuar studentëve punën studimore (matje, llogaritje etj) në sipërfaqet pyjore në vend. Kjo lloj mbështetje u konfirmua dhe nga studentët gjatë takimit të kryer me ta.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton</p>	<p>Pika 3 e Nenit 52 të Rregullores së Programit të Studimit Master Shkencor Inxhinieri Pyjore (Aneks 63) përcakton se "Temat e diplomës udhëhiqen nga punonjësit mësimor-shkencor të Fakultetit që kanë titull ose gradë shkencore (së paku Master), nga punonjësit shkencorë të</p>

<p>cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>instituteve kërkimore që i përshtaten studimeve në FSHP dhe që kanë kualifikim të lartë, si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës përkatëse të diplomimit.”.</p> <p>Udhëheqësi i diplomës me mbështetjen e stafit të specializuar ndihmës akademik, asiston dhe ndjek në mënyrë të vazhdueshme diplomantin gjatë gjithë periudhës së përgatitjes së tezës së diplomës, duke mbikqyrur metodikën, bazën teorike, mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave, konkluzionet dhe rekomandimet si dhe paraqitjen e punimit të diplomës sipas formatit të miratuar nga FSHP. Udhëheqësi garanton origjinalitetin dhe cilësinë e rezultateve, duke firmosur në fund punimin final të diplomës.</p>			
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konfirmon se në përfundim të çdo seance mbrojtjeje ditore, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo diplomanti notën, me të cilën është vlerësuar punimi i tij. Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Proces verbali firmoset nga të gjithë anëtarët e Jurisë, si dhe nga personat e tjerë përgjegjës.</p> <p>Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në mbrojtjen që i bën tezës së tij, ai mund të rimbrotë të njëjtën tezë ose të mbrotë një tezë të re brenda një periudhe jo më vonë se 6 muaj.</p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ konfirmon se në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën Master i Shkencave, firmosur nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UBT, sipas modelit të përcaktuar nga Urdhri i Ministrisë. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin sipas modelit të miratuar.</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Zyra e studimeve dhe studentëve ka detyrimin që me kërkesë të studentëve t'i pajisë ata me një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, sipas tarifave të përcaktuara nga UBT, në gjuhën shqipe ose angleze.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>GVJ pohon se gjithë informacioni për studentët ruhet pranë sekretarisë mësimore dhe mund të tërhiqet prej studentëve të interesuar bazuar në kërkesën e tyre me shkrim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në DVV, dhe vizitës në Institucion, shprehet se: DMBNJ në mënyrë sistematike mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, të personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Kjo, bazuar në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Aneksi 11.2 Rregullore e DMBNJ) të Universitetit Bujqësor të Tiranës, ku bën pjesë edhe Fakulteti i Shkencave Pyjore.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u kerkuan me përzgjedhje rastësore dosje të personelit akademik ku ishin të grumbulluara të gjitha informacionet mbi stafin. Dosja e një pedagogu mungonte ndërsa dosja tjetër përmbante: CV të përditësuar; Diplomë dhe listë notash; Trajnime dhe kualifikime të ndryshme; vendime të Titujve dhe Gradave; Foto; Listë e publikimeve dhe artikujve të botuar.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Rekrutimit të Stafit Akademik, Ndhmës dhe Administrativ në UBT institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura për rekrutimin e stafit akademik referuar përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet (57, 58,59 dhe 67), si dhe STATUTIT te UBT (nenet 29, 30 dhe 31).</p> <p>Referuar Rregullores se Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Pagave, kjo Drejtori ndjek të gjitha procedurat e plotësimit të strukturës me rekrutime të reja, që nga shpallja publike e vendit të punës në Buletinin e APP-së, hartimi i ofertës së punës etj , kriteret e pranimit, ngritja e komisioneve, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, informacioni përfundimtar dhe vendimi i emërimit. DBNJP ndjek edhe procedurat për rekrutimin, kur është e nevojshme, të punonjësve me kontratë të përkohshme (personel akademik, i ftuar dhe jo akademik).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV, rezulton se institucioni ka hartuar procedura dhe kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, siç përcaktohet ne Rregulloren e Rekrutimit të Stafit Akademik, Ndhmës dhe Administrativ në UBT. Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave standarde për mënyrën e rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Ajo përfshin rregulla, kritere & standarde për rekrutimin të personelit akademik , ndihmës akademik dhe administrativ.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me</p>	<p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ takoi drejtuesin e kësaj zyre i cili edhe pse për një kohë të shkurtër në këtë detyrë (detyrë që e mbulonte që prej dy muajsh) na njohu me procedurën që ndiqte kjo Drejtori në lidhje me kriteret e pranimit, ngritjen e komisioneve, vlerësimin e dosjeve, zhvillimin e konkursit, informacionin përfundimtar dhe vendimin e emërimit.</p>

natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	<p>Sipas Zyrës së Burimeve Njerëzore, nevoja për rekrutim të personelit lind në Departament. Përgjegjësi i Departamentit ja transmeton këtë kërkesë Dekanit të Fakultetit i cili me pas e përcjell tek Rektori i UBT. Më pas kjo kërkesë paraqitet në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Pagave e cila bën shpalljen e vendit vakant në Buletinin e APP.</p> <p>Rregullorja e rekrutimit përcakton shpalljen dhe zbatimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për çdo pozicion. Kriteret e përgjithshme përcaktohen nga SENATI i UBT-së. Kriteret e veçanta të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori.</p> <p>Sipas afateve kohore të deklaruara, kritereve të përgjithshme dhe kritereve specifike në përputhje me modulën apo lëndën për të cilën departamenti ka nevojë për staf të ri, bëhet shpallja e konkursit, duke bërë publike kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, komisionin përzgjedhës, ditën, orën, dhe vendin e dorëzimit të dokumenteve dhe/ose intervistës më gojë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur (rregulloret e ndryshme dhe vendimet e Senatit apo rektoratit) dhe bisedat e zhvilluara me drejtuesin e Fakultetit dhe të Departamentit, grupet kërkimore-mësimore dhe stafin akademik rezulton se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi mbështetës dhe mundësi të barabarta të personelit për kryerjen e detyrave. Të gjithë personelit u janë krijuar mundësi të barabarta për kualifikim shkencor dhe përfshirje në projekte kërkimore shkencore. Mjediset e punës, laboratorët, sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka janë lirish të aksesueshme nga personeli për kryerjen me profesionalizëm të detyrave të tyre.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Gjatë takimit me Përgjegjësin e Departamentit, me GVB por dhe me stafin akademik, rezultoi se kualifikimi i vazhdueshëm i stafit që mbulon këtë program studimi, ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e këtij Departamenti. Pjesëtarët e stafit kane marre pjese në konferenca të ndryshme shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, botimet në revista shkencore si dhe projekte kombëtare e ndërkombëtare.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Gjate diskutimit me stafin akademik u theksua se institucioni përveç metodave standarde të mësimdhënies (leksione, seminare, detyra e projekte kursi, praktika profesionale, provime) ka adaptuar edhe disa metoda inovative të mësimdhënies si zhvillimi i orëve të seminarit në mjediset jashtme të kampusit apo zhvillimi i orëve të praktikave mësimore në subjekte që lidhen me programin e studimit.

	<p>Veç kësaj institucioni është angazhuar në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit për përmirësimin e mësimdhënies dhe kualifikimin e mëtejshëm të stafit. Disa nga instrumentet që përdoren përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Google site - Me anë të këtij aplikacioni mund të mblidhen lehtë dhe shpejt një sërë informacionesh në një site të vetëm. Studentët nëpërmjet google site kanë mundësinë të aksesojnë materialet e leksioneve dhe informacionet e digjitalizuara, të ngarkuara nga pedagogu. • Sistemi ESSE3 - është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve, nga aplikimi në Universitet, jetës universitare deri në mbrojtjen e diplomës. Qëllimi kryesor është vënia në punë e një sistemi informativ për të digjitalizuar punën dhe procedurat mësimdhënëse, procedurat administrative të sekretarive mësimore të universitetit. <p>Për sa më sipër, GVJ konstaton se metodat ndihmojnë stafet akademike dhe studentët me forma të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënit.</p>			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	<p>Ngarkesa e stafit të angazhuar direkt në këtë program studimi shkon nga 45 orë deri në 105 orë në vit. Ndërkohë duhet theksuar se stafi akademik është njëkohësisht i angazhuar edhe në programe të tjera studimi të ofruara nga institucioni dhe ngarkesa totale e stafit shkon nga 125 orë deri në 301 orë në vit. Vetëm një pjesëtar i stafit ka ngarkesë me të ulët se norma (125/140) ndërkohë që pjesa tjetër janë të gjithë të mbingarkuar (min 180/165, max 294/90).</p> <p>Nga takimet e realizuara në institucion me drejtuesit dhe stafin akademik pranohet se mbingarkesa nuk është problem.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë dy ditëve të vizitës në Institucion, GVJ pjesë të agjendës së tij, kishte edhe vëzhgimin e ambienteve në funksion të zhvillimit të programit të mësimin, por edhe të ambienteve në funksion të pedagogëve që mbulojnë këtë program studimi. GVJ pati mundësinë të shikonte disa auditorë mësimorë, me kapacitete deri në 60 vende uljeje, të kompletuar me sistemin e kondicionimit, video-projektimi, tabela shkrimi. Sallat janë të pajisura me pajisje moderne elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit (mjete audio-vizive, lidhje me internet), të cilat garantojnë një proces mësimor optimal, teorik e praktik dhe me nivele të larta të mësimdhënies.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që	

garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ vizitoi edhe zyrat e stafit akademik të cilat ishin të kompletuara, komode, me jo më shumë se 2 pedagogë në çdo zyrë.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjate vizitës ne institucion, GVJ vizitoi laboratorin e GIS dhe ate te Dendro-kronologjise. Raporti i vlerësimit te brendshëm përmend si laboratorë edhe klasat ku zhvillohen lendet e botanikes dhe dendrologjise. Laboratori i GIS është i mirë pajisur se fundmi me 13 kompjuterë dhe programe te nevojshme për përdorimin e GIS. Laboratori i dendrokronologjise është i pajisur me mikroskopë e pajisje te tjera matëse te nevojshme për matjen e vlerësimit e drurëve. Studentet kryejnë një sere punësh praktike ne këtë laborator.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	UBT ka në strukturën e tij EDE (Ekonomia Didaktike Eksperimentale), e cila ka për qëllim kryesor të realizojë punën kërkimore-shkencore dhe funksionin didaktik dhe eksperimental për pedagogët dhe studentët e universitetit për kryerje e studimeve të ndryshme dhe praktikave profesionale. Gjate takimit me stafin akademik si dhe me studentet u shprehën rezerva lidhur me mundësitë për te lidhur leksionet teorike me shprehitë praktike. Për mungese fondesh, fakulteti ofron pak mundësi për praktika profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në UBT, GVJ pa edhe mjediset e Bibliotekës Shkencore "Mentor Përmeti". Sipas të dhënave të referuar nga punonjësja e bibliotekës, biblioteka ka një fond prej 2000 librash në gjuhën shqipe dhe të huaja për fusha të ndryshme studimi si dhe 5000 volume periodiku (shqip dhe të huaj). Kjo bibliotekë është e shtrirë në një sipërfaqe prej rreth 1300 m ² dhe përballon nevojat e studentëve dhe stafit akademik për literaturë kërkimi dhe mësimi. Sallat e literaturës janë të organizuara me fonde të hapura të ndara sipas degëve të shkencës. Biblioteka ka krijuar edhe katalogun on-line.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha	

moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Kjo biblioteke ka edhe një sallë me 12 kompjuterë të lidhur me internet nëpërmjet të cilëve mund të shfrytëzohet fondi online TEEAL (The Essential Electronic Agricultural Library) aplikuar në UBT. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe burime të tjera online pa pagesë (p.sh., Google site; MOODLE, Research4life me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI). Salla e kompjuterëve shfrytëzohet nga studentet edhe për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit sipas programeve të studimit			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Bazuar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit, biblioteka harton planin për shtimin e fondit të saj me tituj të rinj apo abonime ne revista shkencore. Ky plan përfshihet në projekt buxhetin e institucionit. Projektet e ndryshme ku janë përfshirë punonjësit e institucionit kanë ndihmuar me futjen titujve të rinj të literaturës bashkëkohore.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka është e hapur nga e hëna në të premte prej orës 8.00 – 16.00. Biblioteka ofron shërbimet dhe kapacitetin e saj pa pagesë e në mënyrë të barabartë për te gjithë studentët dhe stafin qe janë të regjistruar.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.				
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në dokumentet e paraqitura Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS) ka përgjegjësinë e regjistrimit të studentëve dhe mbajtjen e bazës së të dhënave mbi studentët dhe rezultatet e tyre, në formë shkresore dhe elektronike. ZSS plotëson të gjithë dokumentet individuale certifikuese mbi rezultatet e pjeshme ose të plota të studimeve dhe ruan dokumentacionin mbi ecurinë e procesit mësimor. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të institucionit GVJ u njoh me regjistrat e studentëve në format elektronik dhe formë shkresore. Regjistri bazë kishte të dhënat mbi regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi; vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit deri në diplomim, të dhëna për diplomën. Regjistri i notave mban të dhëna për vlerësimin e studenteve gjatë vitit.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës	Në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, UBT ka ndërtuar një sistem për menaxhimin e informacionit online bazuar mbi platformën ESSE3. Ky sistem menaxhon gjithë informacionin dhe dokumentet e stafit akademik, ndihmës e administrativ. Gjatë vizitës në institucion u

akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	shqyrtua edhe dokumentacioni mbi personelin akademik, kryesisht mbi realizimin e procesit mësimor të programit në shqyrtim		
	link i modulit në shqip: http://ubt.edu.al/sites/default/files/albagt_final/albagt_start.html .		
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nëpërmjet këtij sistemi i gjithë stafi apo studentet e regjistruar mund të aksesojnë informacionet e nevojshme mbi programet e studimit si regjistrimin dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave.		
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi lejon aksesimin dhe komunikimin nëpërmjet adresave të postës elektronike		
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	GVJ testoi sistemin dhe rezultoi që ai garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit mësimor. Drejtuesit e institucionit apo personat e interesuar mund të nxjerrin raportime e të dhëna për procesin mësimor dhe aktivitetin akademik.		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Sistemi i menaxhimit të informacionit për momentin është vetëm në gjuhën shqipe. Ndërkohë, faqja e internetit të UBT ofron informacion të hollësishëm për institucionin dhe programet e studimit që ofrohen. http://ubt.edu.al/en_US/		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			✓

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas dokumenteve të paraqitura në DVV, rezultoi se UBT çdo vit paraqet një raport financiar. Gjithashtu, UBT ka përgatitur edhe një plan buxhet afatmesëm për periudhën 2016-2018. Në hartimin e buxhetit afatmesëm UBT ka theksuar se drejtimet kryesore të buxhetit janë:
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit	<ul style="list-style-type: none"> • Rritjen e numrit të stafit akademik, • Mbështetje e kualifikimit të stafit brenda e jashtë vendit • Përmirësimi cilësor i laboratorëve shkencore; • Përmirësimi i cilësisë së kërkimit shkencor nëpërmjet abonimit në revista shkencore dhe funksionimi i bibliotekës online;

<p>të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese, dhe • Mbështetja e pjesëmarrjes në projekte, konferenca e kongrese kombëtare e ndërkombëtare <p>Përveç fondeve buxhetore, që mbulojnë kryesisht shpenzimet për paga dhe investime kapitale, UBT synon të rrisë të ardhurat nga njësitë në varësi të UBT. Këto të ardhura plotësojnë shpenzimet për stafin si dhe nevojat e tjera të institucionit në mbështetje të kërkimit shkencor.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Pranë UBT funksionon Zyra e Auditimit të Brendshëm. Në dokumentet e paraqitura në DVV nuk ka ndonjë raport auditimi të viteve të fundit. Raporti financiar i përmendur me sipër përmban të dhëna të hollësishme financiare mbi kostot dhe të ardhurat përfshirë tarifat e shkollimit dhe burimet e tjera financiare.</p> <p>Aneksi 84. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në dokumentet e paraqitura në DVV, është vetëm raporti financiar për vitin 2017. Plani strategjik dhe buxheti afatmesëm 2016-2018 përmendin aktivitete për përmirësimin dhe diversifikimin e të ardhurave dytësore në UBT.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Ne dokumentet e paraqitura nuk ka të dhëna specifike mbi aktivitetin financiar lidhur me këtë program studimi. Burimi kryesor i financimit është buxheti i shtetit (70-75%) i plotësuar nga pagesat e studenteve dhe fondet e tjera të siguruar nga universiteti nga shërbimet ndaj të tretëve. Numri i kufizuar i studenteve në këtë program studimi është rrezik për qëndrueshmërinë financiare të programit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>✓</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

				✓
--	--	--	--	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura në DVV, rezulton se institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh për zbatimin e politikave dhe përcaktimin e procedurave për pranimin, përparimin, vlerësimin, transferimin dhe diplomimin e studentëve për gjatë gjithë ciklit akademik.</p> <p>Në UBT funksionon Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive, e cila ka në varësi Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA) pranë të cilës është ngritur Zyra e Karrierës së Studentëve (ZKS). ZKS informon dhe orienton studentët për pranimet në programet e studimit dhe ndjek ecurinë e studenteve deri në diplomim.</p> <p>Aneksi 66. Rregullorja e studimeve UBT Aneksi 60. Rregullore e FSHP 2017 – 2018, Aneksi 63. Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Inxhinieri Pyjore. Aneksi 61. Rregullore e zyrës/njesisë së këshillimit dhe karrierës, Aneksi 37. Manuali i Cilësisë. Aneksi 36. Manual si regjistrohen studentet.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregulloret e përmendura me sipër garantojnë akses dhe ecuri të barabartë në programet e studimit për të gjithë studentët bazuar vetëm në rezultatet e tyre akademike. Rregulloret e shqyrtuara nuk përmbajnë kritere diskriminuese apo përjashtuese për grupe të caktuara studentësh. ZKS është e hapur dhe ofron shërbimet e veta për të gjithë studentët. Studentët në mënyrë të barabartë kanë akses në informacionet lidhur me programin e studimit si nëpërmjet faqes së internetit të UBT ashtu edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit (ESSE3). Gjatë takimit me studentët, ata u shprehën të kënaqur me mënyrat e ofrimit të informacionit dhe shërbimeve në ndihmë të tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret e pranimit dhe procedurat e avancimit në programin e studimit bazohen vetëm në rezultatet akademike dhe plotësimin e kërkesave të procesit mësimor (pjesëmarrje në seminare, realizimi i detyrave e projekteve të kursit). Kandidatët për studentë informohen nga ZKS nëpërmjet broshurave, takimeve apo internetit mbi kriteret dhe procedurat e pranimit, përmbajtjen e programit të studimit dhe mundësitë për punësim apo karriere akademike. Metodatat e vlerësimit të dijeve bëhen publike nga pedagogët përkatës në faqen e internetit. Studentët gjatë takimit u shprehën se informacioni ofruar është i mjaftueshëm dhe i dobishëm.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e</p>	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura në DVV si dhe nga vizita në institucion, rezulton se institucioni ka hartuar kritere të veçanta për</p>

<p>kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>përzgjedhjen e kandidatëve që pranohen në ciklin e dytë të studimeve. Këto kritere bazohen në cilësinë e rezultateve akademike (nota mesatare) dhe lidhjen dhe rëndësinë e studimeve të ciklit të parë me programin e ofruar. Çdo vit akademik, institucioni përcakton kuota pranimit në programin e studimit në varësi të kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore për realizimin me cilësi të programit të studimit. Këto kritere publikohen si në faqen e internetit të UBT ashtu edhe në broshura divulgative që përgatiten për promovimin e programit të studimit.</p> <p>Aneksi 66. Rregullorja e studimeve UBT Aneksi 60. Rregullore e FSHP 2017 – 2018, Aneksi 63. Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Inxhinieri Pyjore. Aneksi 61. Rregullore e zyrës/njësisë së këshillimit dhe karrierës, Të dhëna nga faqja zyrtare e ëeb e UBT-së. Aneksi 37. Manuali i Cilësisë.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>UBT para fillimit të çdo viti shkollor përgatit materiale promovuese për programet e studimit që ofron të cilat shpërndahen në studentët që ndjekin programet Bsc pranë UBT, por jo vetëm pranë këtij Universiteti. ZKS zhvillon takime informuese me studentët, takime të cilat janë më shumë orientuese duke marrë në konsideratë edhe dëshirat dhe synimet që kanë këta studentë të Bsc për të ardhmen e tyre. Në këto takime, Studentëve ju komunikohen kriteret e përgjithshme si dhe kriteret specifike të cilat janë të përcaktuar edhe në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Përfaqësuesi i ZKS informoi GVJ se Rektori i UBT dhe Dekani i FBM promovojnë programet e studimit edhe nëpër rrethe, aty ku ka Institucione të Arsimit të Lartë. Gjatë gjithë vitit ZKS mirëpret dhe udhëzon të interesuarit për tu pranuar në programet e studimit të ofruara nga UBT. Të gjitha informacionet publikohen edhe në faqen e internetit të UBT.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit (ESSE3) institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e avancimit akademik (detyrat e kursit, punët laboratorike, detyrime të tjera, provimet), njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjeshme, procedurat e vlerësimit të dijeve, apo punimet e diplomës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të</p>	

kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Sistemi garanton njoftimin e studentëve nëpërmjet e-mailit. Gjithashtu, pedagogët në faqet e tyre personale në internet apo dhe nëpërmjet kontakteve direkt japin informacion të hollësishëm për studentët për lëndët e tyre. ZKS ndihmon studentët të orientohen në gjetjen e informacionit të nevojshëm në mënyrën më të përshtatshme.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.				
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	GVJ ju komunikua se UBT para fillimit të çdo viti shkollor përgatit materiale promovuese për programet e studimit që ofron të cilat shpërndahen jo vetëm në Tiranë por edhe në rrethe. Gjatë gjithë vitit ZKS mirëpret dhe udhëzon të interesuarit për tu pranuar jo vetëm në këtë program studimi, por edhe në programet e studimit të ofruara nga UBT. Të gjitha informacionet publikohen edhe në faqen e internetit të UBT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e prishme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Zyrat e Sekretarisë dhe ZSK informojnë studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve apo veprimtarive formuese. Të gjitha rregulloret përkatëse janë të publikuara online. Gjithashtu studentët informohen edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit apo faqeve personale të pedagogeve në internet. Aneksi 66. Rregullorja e studimeve UBT Aneksi 60. Rregullore e FSHP 2017 – 2018, Aneksi 63. Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Inxhinieri Pyjore. Aneksi 61. Rregullore e zyrës/njësisë së këshillimit dhe karrierës, Të dhëna nga faqja zyrtare e ëeb e UBT-së.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ ju komunikua se Qendra e Karrierës dhe Alumni organizon çdo vit në UBT panairin e karrierës së Studentëve, në të cilin ftohen të marrin pjesë institucione shtetërore dhe ndërmarrje private të cilat mund të ofrojnë punësim për studentët. Gjithashtu, QKA ofron këshillim dhe orientim në tregun e punës për studentët e interesuar. UBT dhe FSHP kanë marrëveshje me një sërë institucionesh e entesh private e

	shtetërore për të nxitur punësimin e studentëve. Pedagogët e modulit menaxhim karriere ofrojnë orientim të vazhdueshëm për studentët në tregun e punës.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjate takimit me studentet rezultoi se ata merren informacione të detajuara mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën direkt nga pedagogët përkatës apo nëpërmjet faqes së tyre të internetit. Po ashtu, sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit dhe Zyrat e Sekretarisë japin informacionin e nevojshëm sipas kërkesave të studenteve duke shpërndarë edhe njoftime me e-mail..			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.				
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Siç kemi theksuar edhe më sipër, sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit (ESSE3) administron gjithë informacionin e nevojshëm mbi aktivitetin mësimor të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Ne zyrën e sekretarisë mësimore GVJ kontrolloi regjistrat e studentëve të programit të studimit në shqyrtim ku janë regjistruar të gjithë studentët e regjistruar dhe të diplomuar ndër vite, konkretisht: Në vitin akademik 2016-2017 rezultojnë të regjistruar 11 studentë, nga të cilët 2 janë diplomuar. Në këtë vit një student është i pa matrikulluar. Në vitin akademik 2017-2018 rezultojnë të regjistruar 14 studentë, nga të cilët vetëm 1 është diplomuar. Në vitin akademik 2018-2019 rezultojnë të regjistruar 11 studentë. Në këtë vit janë 3 studentë të pa matrikulluar. Gjithashtu në regjistrë shënohen edhe tërheqjet apo largimet para përfundimit të studimeve (konstatohet vetëm një rast largimi në këtë program studimi në vitin 2016-2017)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Ne sekretarinë mësimore u panë edhe regjistrat notave të studentëve sipas lëndëve të programit të studimit, të dhëna për temat e diplomave dhe rezultatet e diplomimit të studenteve që kanë përfunduar këtë program studimi.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit	Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit përmban edhe të dhënat statistikore të studentëve. Këto të dhëna janë lehtësisht të

dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	aksesueshme për personat e autorizuar e të regjistruar në sistem. Këta persona përdorin emër përdoruesi e fjalëkalim të autorizuar për të aksesuar të dhënat.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Sekretaria mësimore, bazuar në të dhënat e administruara harton raporte statistikore sipas nevojave të fakultetit apo universitetit përfshirë cilësinë e studentëve që mbarojnë studimet. Zyra e karrierës përmbledh të dhënat mbi punësimin e studentëve që kanë mbaruar programin e studimit dhe mundohet të ndjekë ecurinë e karrierës së tyre për aq sa është e mundur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në rregulloret e paraqitura nga institucioni në DVV sanksionohet përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të UBT. Në UBT funksionojnë edhe Këshillat studentore. Gjatë takimit me studentët ata u shprehen se nuk kane dijeni rreth përfaqësimit të tyre në Senatin e UBT dhe komisionet e ndryshme. Ata thane se nuk i njohin dhe nuk e dine aktivitetin e përfaqësuesve të studenteve në këto forume..
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Aneksi 66. Rregullorja e studimeve UBT Aneksi 60. Rregullore e FSHP 2017 – 2018,
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Programi i studimit është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studenteve dhe garanton një shpërndarje pothuajse uniforme të ngarkesës në semestra të ndryshëm gjatë ciklit të studimit. Procedurat e përparimit dhe njohjes së studimeve të mëparshme janë të hapura e të njohura nga të gjithë studentët. Sipas studentëve ngarkesa e lëndëve është në përpjesëtim të drejtë me numrin e krediteve. Studentët nuk paraqiten ndonjë ankese për procedura burokratike e të tej zgjatura. Aneksi 30. Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave në 2018-2019 Aneksi 44. Orari mësimor i Masterit shkencor, Semestri i parë dhe i dytë (Viti Akademik 2018-2019) Aneksi 15. Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave Inxhinieri Pyjore (2016-2017, 2017-2018, 2018-2019)
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në	

procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Për të garantuar përfshirjen e opinionit të studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit, institucioni kryen anketime të rregullta të studentëve dhe mundohet të reflektojë sugjerimet e tyre. Nëpërmjet këtyre anketimeve studentët shprehen edhe mbi ndershmërinë dhe barazinë në procesin e vlerësimit të dijeve.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës	Në dokumentet e paraqitura dhe në takimet gjatë vizitës në institucion, nuk na u paraqit një kanal formal ankimi në dispozicion të studentëve. Sidoqoftë, studentet u shprehen se arrijnë ti adresojnë shqetësimet e tyre direkt me pedagogët apo me drejtuesin e departamentit e fakultetit nëse është e nevojshme. Aneksi 54.Raporte të analizës mësimore vjetore mbi ecurinë e programeve të studimit Aneksi 55.Raportet e anketimit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Nga dokumentet e paraqitura në DVV dhe nga takimet me stafin akademik rezulton një pjesëmarrje e kënaqshme e stafit akademik në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Gjithashtu është paraqitur një listë me publikimet e stafit Akademik të kategorisë “Profesor”, publikime/abstract book/referime etj, të konsiderueshme në numër. Aneksi 3. Analiza e punës shkencore 2018 Aneksi 4. Book proceedings Aneksi 11.CV e stafit akademik Aneksi 56.Raporti i Analizës së veprimtarisë kërkimore UBT 2017 Aneksi 74.Tabela e shkallës së kualifikimit të personelit akademik
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Sipas dokumenteve të paraqitura në DVV, FSHP ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione kërkimore shkencore e të arsimit të lartë kombëtare e ndërkombëtare (Prizren, Prage, Ebersäald). Këto marrëveshje garantojnë përfshirjen e stafit në aktivitete të mirëfillta kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit. Aneksi 39.Marrveshje bashkëpunimi FSHP-Institucione nderkombetare
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	GVJ konstaton se Stafit akademik i nxit studentët e programit Master shkencor të përfshihen në aktivitete kërkimore shkencore e si rrjedhim të shkruajnë e publikojnë punime shkencore, kryesisht gjatë realizimit të diplomës (mikrotezës). Aneksi 31.Libri i Proceedings për konferencën studentore
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore	Parimisht institucioni mbështet publikimin në revista shkencore të stafit akademik, por mungesa e mbështetjes financiare e bën të pamundur

ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	pagesën e kuotave të kërkuara për botim. Pedagogët detyrohen të paguajnë vetë tarifat e botimit në rast se duan të botojnë në revista të njohura e me faktor impakti			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Personeli akademik nxit pjesëmarrjen e studentëve në kërkimin shkencor dhe disa nga temat e trajtuara në këtë program studimi janë inovative përfshirë modelimin e trajtimit të pyjeve sipas karakteristikave të terrenit, analizimi i kushteve stacionale të rritjes së drurëve nëpërmjet dendrokronologjise, etj. Laboratori GIS jep një ndihmë të konsiderueshme në këtë drejtim.			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Prezenca e laboratorit GIS dhe të dendrokronologjise është një ndihmë e madhe për këtë program studimi. Personeli akademik nxit dhe ndihmon studentët të kryejnë vetë analizat e nevojshme në laborator. Sidoqoftë në DVV dhe në takimet me stafin akademik dhe studentet shprehet nevoja për me shumë pajisje të laboratorit që do të ndihmonin studentet të përfitonin sa më shumë shprehje praktike..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Null përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura në DVV, por edhe në takimet e ndryshme të realizuar gjatë vizitës, GVJ Ju komunikua se UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me universitete të tjera publike e jo publike si dhe me institucione kërkimore kombëtare. Stafi i UBT bashkëpunon në kuadër të projekteve të ndryshme (IPA, Erasmus, Horizon 2020. Gjatë takimit me stafin dhe studentet u theksua se bashkëpunimi me institucionet kërkimore është me interes për zhvillimin e kërkimit shkencor.</p> <p>Konkretisht UBT aktualisht ka 44 marrëveshje aktive bashkëpunimi me Institucione të Arsimit të Lartë nga vende të ndryshme në Evropë, Azi, Kosovë dhe Shqipëri. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është zgjerimi dhe forcimi i bashkëpunimit shkencor dhe arsimor. Ndërsa disa prej objektivave janë: Shkëmbimi i personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; Shkëmbimin e studentëve; Shkëmbimin e stafit administrative; Nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore – shkencore; Organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, etj. Shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore etj.</p>
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe	Personeli akademik i nxit studentet të përfshihen në aktivitete kërkimore duke shfrytëzuar edhe laboratoriet shkencor pranë departamentit. Një pjesë e mirë e temave të diplomës përfshijnë

përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	kryerjen e analizave në laborator, çka ndihmon studentët të fitojnë shprehitë e duhura për vazhdimin e kërkimit shkencor								
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Gjatë takimit me stafin akademik dhe me studentet u theksua se pedagogët mundohen të përfshijnë studentet në projekte kërkimore kryesisht gjatë realizimit të temave të diplomës. Ka disa artikuj të botuar ku studentët janë bashkautorë. Ankesi 31.Libri i Proceedings për konferencën studentore								
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Bazuar në dokumentet e paraqitur ne DVV, UBT ka politika që mbështesin afrimin e kërkuesve të huaj në institucion								
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Nga takimet me drejtuesit e departamentit por edhe në takimin me studentet rezultojnë se institucioni mbështet lëvizjen e studentëve që angazhohen në veprimtari kërkimore ndërkombëtare. Sidoqoftë vitet e fundit nuk ka pasur lëvizje të studenteve në programin e studimit master shkencor. Gjatë takimit me studentet ata u shprehën se nuk janë përfshirë në programe shkëmbimi.								
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete ndërkombëtare, të cilat mbështesin lëvizjet e stafit akademik dhe studenteve. Nga dokumentet e paraqitura rezultojnë se ndër vite ka pasur një numër studentesh apo kërkuesish të huaj që kanë qëndruar për afate të ndryshme kohore pranë UBT.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>✓</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			✓	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		✓							

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Zyra e Studimeve dhe Studenteve (ZSS) është në shërbim të studentëve dhe ofron informacione të nevojshme lidhur me ecurinë e tyre në procesin mësimor.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Siç kemi theksuar edhe më sipër, në UBT funksionon sistemi i menaxhimit të informacionit ESSE3, i cili siguron informacionin e nevojshëm për studentët. Gjithashtu, pedagogët dhe drejtuesit e departamentit ofrojnë mbështetje dhe udhëzime për studentët sipas nevojave të tyre.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar	Qendra e Karrierës dhe Alumni siguron mbështetje për studentët lidhur me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe orientime për karrierën e mëtejshme.

informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Sipas të dhënave të referuara gjatë takimit me QKA, kjo zyrë mundohet të mbledhë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e diplomimit të studenteve. Rezulton se të dhëna të pakta mblidhen gjatë vitit të parë pas përfundimit të studimeve dhe më pas kontaktet ndërpriten. Nga statistikatat e mbledhura rezulton se një pjesë e mirë e të diplomuarve janë punësuar jashtë profilit (call center, menaxher shitjesh).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Statuti i UBT dhe një sërë Rregulloresh të miratuara përcaktojnë politikat dhe strukturat për Sigurimin e brendshëm të cilësisë. Pranë senatit të UBT funksionon Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor, i cili harton politikat dhe procedurat për garantimin e vazhdueshëm të cilësisë. Aneksi 37. Manuali i Cilësisë. Aneksi 66. Rregullorja e studimeve UBT Aneksi 60. Rregullore e FSHP 2017 – 2018, Aneksi 63. Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Inxhinieri Pyjore
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe	Njësia e Sigurimi të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë në gjithë programet e studimit të UBT. Ajo bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet për vlerësimin periodik të programeve mësimore, cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Pyetësori për studentët që realizohet çdo fund semestri është një nga instrumentet e përdorura për sigurimin e cilësisë.

bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Aneksi 61. Rregullore e zyrës/njesisë së këshillimit dhe karrierës, Të dhëna nga faqja zyrtare e ëeb e UBT-së. Aneksi 37. Manuali i Cilësisë. Aneksi 55. Raportet e anketimit		
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	UBT ka përfunduar akreditimin institucional. Programi i studimit “Master i Shkencave“ në Inxhinieri Pyjore po i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë.		
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	Siç kemi përmendur me sipër institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Raporti vjetor i monitorimit analizon cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të realizuar në të gjitha njësitë bazë. Ai vlerëson preferencën e stafit akademik, gjendjen dhe cilësinë e infrastrukturave e pajisjeve, funksionimin e zyrave mbështetëse (ZSS, QKA), financimin e qëndrueshëm të programeve të studimit, ngarkesën e stafit dhe nevojat për rekrutime, etj. Raporti i hartuar në bazë departamenti, fakulteti e universiteti, garanton përfshirjen e gjithë njësive përbërëse dhe aktorëve të brendshëm. Aneksi Raporte të analizës mësimore vjetore mbi ecurinë e programeve të studimit (54) Aneksi 55: Raportet e anketimit		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht ✓

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional pranë të cilit funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është njësia e posaçme përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të studimit dhe Kërkimit Shkencor në nivel universiteti i raporton senatit mbi vlerësimin dhe rishikimin e programeve të studimit. Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor” në fakultet shqyrton paraprakisht propozimet për ndryshimin/rishikimin e kurrikulave dhe programit mësimor. Departamenti është përgjegjës për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin e kurrikulave

	Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri pyjore nuk ka pësuar ndryshime që nga viti 2009.			
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Në dokumentet e paraqitura në DVV, rezulton se institucioni përdor procedura formale e të dokumentuara për shqyrtimin dhe miratimin e programeve të studimit. Procedura fillon me propozimin e departamentit, shqyrtimin nga komisioni i posaçëm, kalimin nëpërmjet dekanit dhe rektorit në Senatën e UBT për miratim. Sipas Rregullores së studimeve të Fakultetit të Shkencave Pyjore, fakulteti organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Rishikimi i programit të studimit dhe ndryshimet në kurrikul kryhen sipas procedurës së përcaktuar për ndryshimin e kurrikulës.			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Instrumentet e përdorur për vlerësimin e cilësisë përfshijnë anketimet dhe pyetësorët për studentet, formularin e vlerësimit të performancës së stafit akademik, inspektimet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, vlerësim të detyrave dhe provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve apo praktikës profesionale, kontrolli i plotësimit të ngarkesës mësimore e akademike.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raportet periodike të vlerësimit i paraqiten Dekanit, Rektorit dhe diskutohen në Senatën e UBT, i cili miraton planin e masave për adresimin e problemeve të evidentuara. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor publikon raportet vjetore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë. Aneksi Raporte të analizës mësimore vjetore mbi ecurinë e programeve të studimit (54)			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet vjetore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, të hartuara në nivel departamenti dhe fakulteti, përfshijnë rezultatet e vlerësimit dhe masat që duhet të merren për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Raportet janë të periodike dhe të përvitshme dhe në to publikohen rezultatet e vlerësimit. Nga takimet me drejtuesit e departamentit u theksua se ndër vite ka pasur një sërë masash që janë realizuar në plotësim të gjetjeve të raporteve të vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në	Departamenti i Mbarështrimit të pyjeve, ka vlerësuar në mënyrë periodike programin e studimit. Rezultat e vetëvlerësimit të brendshëm lidhur me cilësinë dhe ecurinë e procesit mësimor janë përfshirë në Dosjen e Vetëvlerësimit për Akreditim.

vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Aneksi 100: Raporti i Vlerësimit te Brendshëm FSHP			
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Siç e kemi përmendur edhe me sipër, institucioni ka përdorur metoda te ndryshme për vlerësimin e cilësisë ku përfshihen metodat e drejtpërdrejta si inspektimet gjate zhvillimit te procesit mësimor, vlerësim paralel të detyrave dhe provimeve të studentëve, vëzhgime gjate kryerjes se ushtrimeve apo praktikës profesionale; dhe metoda te tërthorta si kontrolli i plotësimit të ngarkesës mësimore e akademike, anketimet dhe pyetësorët për studentet, formularin e vlerësimit te performances se stafit akademik, diskutime me institucionet partnere.			
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.				
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				✓

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe	Nga dokumentet e paraqitura ne DVV, rezulton se institucioni parashikon përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe te jashtëm në procesin e sigurimit të cilësisë. Për këtë qellim FSHP ka realizuar

të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	një numër takimesh e diskutimesh me pjesëmarrje të gjerë ku janë diskutuar probleme të cilësisë së programit të studimit.			
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Manuali i cilësisë dhe rregulloret e funksionimit të Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat e gjithë strukturave (stafi akademik e ndihmës i departamentit, fakulteti, njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, komisionet e posaçme) apo individëve (shefi i departamenti, dekani, rektori) që marrin pjesë në procesin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit, përfshirë edhe studentet.			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Rregulloret e sipërpërmendura garantojnë përfshirjen e aktorëve të brendshëm (stafi akademik, ndihmës e studentet) pa dallime e diskriminime dhe në respekt të integritetit akademik.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.				
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të cilësisë kryhet nëpërmjet konferencave e takimeve të organizuara në nivel fakulteti apo universiteti. DVV nuk ka të dhëna sasiore (listë personash të ftuar) për përfshirjen e aktorëve të jashtëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Të gjitha dokumentet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë (manuale, rregullore, vendime) në UBT janë bërë publike nëpërmjet publikimit në faqen e UBT apo afishimit në mjediset e UBT. Janë të aksesueshme dhe GVJ pa disa prej tyre gjatë vizitës. Po ashtu edhe aktivitetet që lidhen me sigurimin e cilësisë njoftohen si më sipër. Studentët, stafi akademik dhe ndihmës kanë mundësinë të marrin gjithë informacionin e duhur mbi këto procese.

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Edhe raportet e vlerësimit janë bërë publike sipas përcaktimeve në rregullore duke respektuar etikën akademike dhe përcaktimet ligjore për të dhënat personale. Raportet janë diskutuar në takime e mbledhje të hapura me pjesëmarrjen e stafit akademik, ndihmës dhe studentëve.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raportet e vlerësimit shoqërohen me rekomandime dhe propozime masash për adresimin e çështjeve ete ngritura dhe përmirësimin e cilësisë të cilat diskutohen dhe miratohen nga senati i universitetit Aneksi 45: Plani i masave për vitin akademik 2018-2019.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sipas informacioneve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, një pjesë e mirë e masave të parashikuara në raportet e vlerësimit ndër vite janë realizuar duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Fakulteti i Shkencave Pyjore ka organizuar herë pas here aktivitete si me stafin akademik e ndihmës ashtu edhe me studentët për ti informuar dhe ndërgjegjësuat ata lidhur me procesin dhe rezultatet e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Inxhinieri Pyjore” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit mbulon një fushë parësore për vendin, është unik (nuk ofrohet nga IAL te tjera) dhe mbulon më së miri tregun e punës që ka kërkesë për Inxhinier Pyjorë;
2. Staf i akademik, në dispozicion të realizimit të programit të studimit, është mjaft i kualifikuar dhe i përfshirë në veprimtari kërkimore që ndihmojnë programin;
3. Programi i studimit është i mirëstrukturuar, i mbështetur në programe të ngjashëm të universiteteve të njohura të Europës, dhe jep njohuri të mjaftueshme për formimin e inxhinierëve pyjorë;
4. Diploma e programit njihet ose konvertohet lehtësisht në vendet e BE.;
5. Bashkëpunim i mirë me institucionet qendrore që merren me çështjet e menaxhimit dhe ruajtjes së pyjeve;
6. Infrastruktura e mjaftueshme dhe mjediset e përshtatshme në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik.

Pika të dobëta

1. Mundësi të kufizuara financiare për mbështetjen e praktikave profesionale të studentëve para diplomimit, financim i kufizuar për kërkimin shkencor dhe bazën laboratorike si dhe mungesë e një plani buxhetor të qartë për të rritur cilësinë e programit nga ana mësimore dhe kërkimore;
2. Numër i vogël studentësh dhe cilësi e dobët e studentëve në hyrje.
3. Kontaktet e pakta me tregun e punës dhe situata jo e qartë lidhur me ndryshimet e vazhdueshme strukturale të sektorit pyjor në vend vështirësojnë vizionin mbi sektorin dhe kuptimin e kërkesës së tregut për profesionistët e formuar nga ky program;
4. Kurrikula e programit të studimit nuk është ndryshuar që prej vitit 2008. Këshillim i pamjaftueshëm me studentët për përmirësimin e kurrikulës.
5. Nuk ka profilizim të programit të studimit sipas kërkesave specifike të tregut të punës. Mungesa e moduleve në gjuhë të huaj pengon pjesëmarrjen e studentëve të huaj dhe ul mundësitë për mobilitet të studentëve vendas.
6. Ndërpreja e ciklit të tretë të studimeve si vështirësi për vazhdimësinë e studimeve të thelluara.

Rekomandime

1. FSHP duhet të hartojë një plan buxhetor specifik për të rritur cilësinë e programit e sidomos mbështetjen për shtimin e ditëve për praktikat profesionale të studentëve duke u mundësuar më shumë vizita në terren, shtim real të financimit për kërkimin shkencor dhe bazën laboratorike me synim akreditimin teknik dhe përforcimin e njohurive të studentëve, duke i bërë ata më të përgatitur për tu futur në tregun e punës. Plani duhet të miratohet dhe monitorohet në organet vendimmarrëse të UBT.
2. Zhvillimi i mëtejshëm i kurrikulës së studimit bazuar në një studim më të plotë të segmenteve të tregut të punës do të ndihmojë në përthithjen e studentëve më të shumtë në këtë program studimi.
3. Marketingu i deritanishëm ka nevojë të përmirësohet ndjeshëm në masë dhe në formë. Marketingu duhet të prekë të gjithë tregun e punës dhe qasja duhet të jetë më proaktive. Panairi i punësimit mund të zgjerohet ndërkohë që formate on-line të marketingut mund të përdoren gjerësisht.
4. Duhet të kryhen ndryshime të kurrikulës që lejojnë profilizimin e programit të studimit, duke prodhuar specialistë me profile të përshtatshme për tregun e punës. Departamenti i Pyjeve dhe FSHP duhet të zgjerojnë këshillimin me studentët për ndryshimin e kurrikulës.
5. Mbështetur në eksperinecën e mirë të bashkëpunimit me institucione homologe Evropiane, zhvillimi i moduleve në gjuhë të huaj mund të rrisë pjesëmarrjen e studentëve të huaj dhe mundësitë për mobilitet të studentëve vendas.
6. Gjurmimi më i mirë i studentëve me mënyra më efikase do të japë informacion edhe mbi fokusimin dhe shtjellimin më të gjerë të lëndëve të vecanta, duke krijuar mundësi për të nxjerrë specialistë më të thelluar në njohuritë dhe aftësitë praktike të tyre.
7. Vazhdimësia e ciklit të tretë të studimeve duhet të konsiderohet si parësore për të siguruar vazhdimësinë e studimeve të thelluara.

Conclusions of the evaluation of the second cycle study program, Master of Science in “Forest Engineering” of Higher Education Institution “Agricultural University of Tirana”


Strong point and confirmations

7. The program covers a primary subject, unique in the country (not offered by any other Higher Education Institution) and fulfills at best the market demands for forest engineers.
8. Academic personnel dedicated to this program is well qualified and involved in research activities that support the delivery of the program
9. The program is well structured, based on similar programs from renown European Universities, and provides adequate knowledge and skills necessary to forest engineers
10. The degree (diploma) is recognized and/or easily convertible to EU countries.
11. There is good cooperation with central government institution dealing with forest management and governance issues.
12. There are adequate facilities and appropriate infrastructure available to students and academic personnel.

Weak points

7. Limited financial opportunities for supporting practical professional training of students, limited financing for research and laboratory equipment, lack of a clear financing program to ensure improved quality on both research and education activities within the program.
8. Low number of students and low quality of entry students
9. Limited contacts with the job market and unclear situation of the forestry sector undergoing various institutional restructuring hinder the proper understanding of market demands for professional experts provided by this program.
10. Program curricula have not changed since 2008. Limited consultation with the students on curricula improvement.
11. There is no specialization foreseen on the program according to specific demands of the job market. Lack of modules delivered in foreign languages hinders the participation of foreign students and limits mobility opportunities for national ones.
12. Lack of opportunities to follow up PHD studies.

Recommendations



web site: www.ascal.al

8. The Faculty of Forestry Sciences should develop a specific financial plan to ensure improved quality of the program, especially in supporting additional field days for professional and practical training of students, providing real increase in the financial support for research and laboratory equipment aiming at technical accreditation and enhanced student knowledge and skills, preparing them better for the job market. The plan has to be approved and supervised by AUT authorities.
9. Further development of the program curricula based on a comprehensive study of the market segments will help on attracting more quality student in this program.
10. There is a need to improve marketing campaign in both form and content. Marketing campaign should cover all segments of job market and the approach should be more proactive. The job fair can be expanded and on line, marketing should be used more widely.
11. It is necessary to make some changes on the program curricula to allow for specialization of the program preparing specialists having profiles required in the job market. The Forestry Department within the Faculty of Forestry Sciences should improve the student consultation process for improving the curricula.
12. Based on best experience of similar European institutions, delivering modules in foreign languages would increase participation of foreign students and improve mobility of national students.
13. Better student tracking using more effective ways will provide useful information on focusing and better development of specific topics providing opportunities to prepare specialists with specific in depth knowledge and skills.
14. The opportunity to continue PhD studies will improve sustainability.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			✓	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
VLERËSIMI TËRËSOR				